

INTERVISTË ME NERIMANE KAMBERIN

Nerodime | Data: 19 korrik, 2021

Kohëzgjatja: 138 minuta

Të pranishëm:

1. Nerimane Kamberi (E intervistuar)
2. Anita Susuri (Intervistuesja)
3. Korab Krasniqi (Intervistuesi)
4. Besarta Breznica (Kamerë)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Anita Susuri: Zonja Neriman nëse mundeni me u prezantu, datën e lindjes, vendin, diçka për familjen e juaj, prejardhjen?

Nerimane Kamberi: Unë quhem Nerimane Kamberi, insisto Nerimane, tash është çështje gjuhësore se unë kam lindë Neriman Kamberi, që tregon prejardhjen nga vi unë. Vi nga Presheva, domethonë ni qytet me kulturë otomane të themi siç ka qenë atëhere në ish-Jugosllavi. Dhe emri im domethonë është emër turk. Edhe pastaj kur kam ardhë të jetoj në Kosovë edhe të studioj e kanë shqipëruar Nerimane, se Neriman tingëllon shumë mashkullore. E lidha këtë domethonë me prejardhjen nga vi.

Jam lindur në Preshevë dhe shumë herët kemi emigru në Belgjikë, ishin vitet e '60-ta kur kërkohej punë, punëtorë shumë atje në Belgjikë. Dhe halla ime e cila... domethonë për t'ju kthyer historisë sigurisht që kjo më ka metë shumë në kujtesë, halla ime ishte largu prej Preshevës në të '50-tat, në kohën e Rankoviqit, në kohën kur shqiptarët hjeknin shumë dhe kishte shkuar të jetoj në Turqi. Dhe faktikisht ajo gati nontë vite nuk ishte kthyer në Preshevë, ishte vërtetë ai gurbeti, që them une gurbeti i kangëve.

Nontë vjet nuk ishte kthyer por nuk kishin arritë të krijojnë një jetë të re atje, të mbijetojnë dhe janë kthyer. Mbaj në mend imazhe, unë gjithashtu edhe shkruaj kështu që punoj shumë me imazhe që m'u kanë fiksuar në mendje. Kur është kthyer te dera e oborrit të shpisë osht' alivanos. Domethonë, sepse ka qenë me të vërtetë ai gurbeti i rondë. Dhe prej aty kanë shku në Belgjikë.

Edhe siç thashë ishin vitet e '60-ta, fundi i kolonializmit, ku Belgjika ishte një fuqi koloniale e fortë, tani kishte krijuar edhe ajo një pasuri dhe rindërtonte, ndërtonte, rindërtonte Belgjikën. Dhe halla ime e thirri babën, faktikisht ishte jetim pa babë dhe shumë i ri, i shkathët kishte marrë përsipër të mbikëqyrë familjen e tij edhe kishte punuar tetë vjet në ndërtim në Beograd. Kështu që, kishte një

përvojë dhe ishte ajo gjeneratë e shumë shqiptarëve, sidomos preshevarë që punonin në Beograd, i cili gjithashtu ndërtohej.

Edhe prej aty ai kishte marrë një zanat të mirë dhe vendosi pra të shkoj në Belgjikë. Unë e kam shkru një tregim në frëngjisht pikërkisht për këtë nisjen tonë qysh e mendoj, se kam qenë një vjet e gjysmë, gati dy vjeçe po nuk e mbaj në mend. Mbaj mend prej kujtesës nonës, prej rrëfimeve të saj, prapë domethonë ai gurbeti i randë dhe kemi jetuar pra në Belgjikë 20 vite.

Dhe unë jam ushqyer me dy kulturat me të cilat vazhdoj edhe tash të ushqehem, dy kultura edhe dy kujtesa. Domethonë, nga ana e familjes mbaj në mend stërgjyshin tim, që ende domethonë nuk i kemi gjetë eshnat e tij. Kur kishte luftuar kundër sërbeve në atë kohë te ura e Sopotit, thotë baba. Dhe interesant ndoshta kam dëshirë të shkoj në ato vende dhe nuk kam dëshirë. Kështu që, nuk kam shku kurrë, e osht' shumë imagjinare ajo ura e Sopotit, ku janë pushkatu shqiptarët atëherë, ndër të tjerë edhe stërgjyshi im.

Në anën tjetër axha i babës, ka mbetur, i ka bërë 20 vjet burg në Sërbi, në kushte shumë të ronda. Për shkak se ishte kundër sërbeve, domethonë kishte luftuar kundër tyre gjatë Luftës së Dytë dhe në anën tjetër është edhe simbol ku jeta e mund tmerrin edhe vdekjen. Se ai pas 20 vjete është kthi në Preshevë, ka kriju familje, i ka bo shtatë fëmijë. Edhe domethonë kjo ishte ajo kujtesa.

Kultura tjetër me të cilën u ushqeva e u rrita osht' kultura belge, kultura frankofone të themi. Respektimi i të drejtave të njeriut, jetoja atje ku gjithçka ishte në rregull, ku nuk kishe frikë nga asgjë, ku i kishe të drejtat e tua si i huaj edhe ku faktikisht nuk ndiheshe si e huaja. Edhe në shkollë motrat, vllau dhe unë, vëllau nuk ishte ende i lindun po kemi qenë nxanës shumë të mirë, gjithmonë ajo që ta tregojmë vetën. Edhe në shpi kishmi një edukatë shumë shqiptare.

Domethonë, babai im ka qenë ai i cili na ka shtyer, dhe e falenderoj, që të flasim gjithmonë shqip në shpi, që t'i festojmë festat të gjitha, qofshin kombëtare, qofshin fetare, ta kemi atë. Edhe ka bërë çdo gjë që çdo verë të kthehemi në vendlindje, për të ishte diçka shumë e randësishme. Kursente familja tonë jetën sepse ishim gjashtë fëmijë ishte një familje domethonë me të ardhura mesatare. Edhe ai edhe nana ime kishin dy; gjithmonë kishin dy rrugë ishin që ne të shkolloheshim edhe ta donim vendin e tyne, vendin tonë.

Edhe jemi rritë me atë kështu që lidhur me atë edukatë me të drejtat e njeriut, për respektin e simboleve tua, e gjuhës tande këtë e kam domethonë prej familjes, po sidomos prej kulturës edhe shkollimit që kisha në Belgjikë. Kështu që, në mënyrë shumë të natyrshme kur e kom mbaru shkollën e mesme, maturante edhe pse unë isha shumë e mirë në gjuhë të huaja, nxansja sigurisht ma e mirë, flisja anglisht, flamanisht, gjermanisht.

Por, unë doja ta studioja drejtësinë për mua ishte shumë e rëndësishme kur vija verës në Preshevë, në Kosovë gjithmonë biseda me familjarë, me miq për kushte të shqiptarëve. Kishim edhe miq nga Presheva që ishin të burgosur politik në atë kohë, sigurisht idealin e Adem Demaçit e tjera. Edhe arsimtarët e mi në shkollë të mesme, “Nerimane, do të shkosh në gjermanisht apo në anglisht?” Une, “Jo, du me studiu juridikun”.

Ishte koha kur ne bojshim, nënshkrujshim peticione të Amnesty International, nënshkrujshim peticione për m’i mbrojt shtazët, për m’i mbrojt njerëzit, ishte ajo frymë që kishim në Belgjikë të cilin nuk e gjeja këtu kur visha si 16-17 vjeçare. Kur faktikisht formohet edhe karakteri edhe idealet. Kjo pra osht’ ajo ai formimi im i parë arsimor, shkollor, të themi edhe atdhetar a, ta përdormi edhe këtë fjalë. Dhe unë studiova pra në Belgjikë dy vite drejtësi dhe ku edhe më shumë domethonë e pashë atë dëshirën time që të punoj në atë drejtim.

Ndërkohë, kisha shkru dy romane në Belgjikë, dy romane për të ri. Të parin e botova atje në frëngjisht edhe u bëra në thonjëza një senzacion në Kosovë, në shqiptari, se isha 14 vjeçe vinja nga, nga tash që pe çujnë diaspora, atëherë s’ka ekzistuar si term. Po vija domethonë nga shqiptarët e jashtëm, nga gurbetqarët edhe shkruaja në frëngjisht. Ishte një letërsi e panjoftun këtu sepse ishin romane kriminalistike edhe u përkthye këtu nga “Rilindja” edhe i pari edhe i dyti.

Kështu që, u bëra në emër i njoftun këtu. Kështu që, ne kur vendosi baba me u kthi sepse doli para-pension në Belgjikë, ishte një krizë atje ekonomike, s’kishte më punë. Po edhe ai e pa që ishte koha që të kthehej familja, që ne të shkolloheshim këtu në shqip, të krijonim jeta të reja këtu edhe vendosëm të kthehem në Preshevë.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet diçka para se me vazhdu andej. Ka pasë shumë shqiptarë që kanë dalë jashtë Kosovës për punë, diaspora siç e cekët. Po shumica e tyre kanë shku vetëm, për shembull familjari babai, ose si ka qenë atëherë i zoti i shpisë. Po si ndodhi që krejt familja ju keni shku?

Nerimane Kamberi: Po, osht’ e saktë ashtu se unë kam shumë kushëri në Preshevë të cilët kishin shkuar në Gjermani, kanë shkuar vet. Është një pyetje ndoshta që do t’ja shtroja babës tem, se s’ja kom shtru kurrë. Une mendoj se ai ka vujt shumë, se tetë vite ka jetu në Beograd, ka qenë i pamartum në atë kohë. Sigurisht ka vujt për ato që nana vet ka mbetë e ve shumë e re edhe gjyshja ime ka qenë e hendikepume, domethonë nuk ka mujt mo me ecë në momentin që i ka vdekë burri.

Edhe mendoj që të gjitha këto elementet kanë bo që ai nuk ka dashtë të shkoj vet. Edhe sigurisht mendoj që osht’ vendim i mirë për të ma së pari sepse tani kur i shoh kushërinjtë e mi. Apo kur e mendoj vjehrrin tim të ndjerë që kanë shku vet, sigurisht që ata kanë, kanë, kanë pasë një jetë, një jetë filmash turk (qesh) si të themi, filmash të gurbetqarëve të cilët kanë sakrifiku jetën. Kanë bërë jetë tepër, tepër modeste dhe i ka munguar gjithmonë ajo për të qenë i lidhur.

Unë e mbaj në mend vjehrrin tim kur kthehej dhe ai nuk donte më të dalë, donte veç t'i ketë të vetit përreth. E ke ni ndjenjë që të ka shku jeta për sakrificë sigurisht. Por, baba jem s'ka dashtë ashtu, e ka marrë nanën. Mirë e di që nana ime ka vujt shumë për atë se ka shku nuse shumë e re, nuk ka ditë gjuhë. Fillimisht nuk kemi jetu në kushte shumë të mira, domethonë një shpi modeste, në një katun modest. Kam kujtime për këto po tash ndoshta dalë prej kësaj, mbaj në mend na ka ndihmu shumë kisha kur kemi shku, si gjithmonë.

Edhe ne në shkollë publike, ishin ende katolike në atë kohë edhe e mbaj në mend kur shkova edhe na çunë m'u rrëfy te prifti edhe ai na nji fke që nuk ishim familje me kulturë katolike me fe. Edhe më sheh, isha gjashtë vjeçe po e mbaj në mend shumë mirë si kujtim, po thotë, "Ti çka lyp këtu?" Thashë, "Kom ardhë m'u rrëfy si krejt nxanësit" (qesh). Edhe s'di ma tha ni fjalë të mirë, edhe më nxori shumë kështu në mënyrë të ngadalshme, të sjellshme prej kishës. Edhe jonë këto doemthonë, po pastaj shumë shpejt e kemi marrë vetën, baba ka punu shumë, nana ka qenë amvise.

Edhe neve komuna na e ka dhonë ni banesë të madhe, me kushte shumë të mira, sepse kemi qenë fëmijë shumë. Edhe sigurisht që kemi qenë shembullor, në atë pjesë s'kemi pasë kurrë probleme. Harrova ta ceki se në ato, në ato dëshirat e babës [që ne] gjithmonë me qenë na shiptarë e mos me harru vendin, ai ka bërë çmos që ta organizoj dhe ta hapë shkollën shqipe në atë kohë. Sigurisht, pra që ishte ish-Jugosllavia, kishmi ambasadën e Jugosllavisë në Beograd, që normal merrej me qytetarët e vet, me jugosllavë që quheshin atëhere. Por, baba boni çmos që të hapej shkollë shqipe edhe u hapë shkollë shqipe dhe vinin arsimtarë prej Kosove që na mësonin.

Ishte shumë interesant se ne flisnim shqip, po në shpi ishte shqipja jonë e Preshevës edhe ajo erdhi me shqipen standarde në fillim nuk e kuptonim mirë se çka donte. Por, sigurisht, aty gjuhën shqipe, poezitë e para, autorët e parë edhe unë edhe në shkollë maturante, provimin e maturës e kom pasë krahasimin e Naim Frashërit "Bagëti e bujqësi" me ni autor latin të themi, me Virgjilin. Pastaj edhe në fakultet në Belgjikë në punim e kom pasë "Bardhën e Temalit" të Pashko Vasës. Kjo osht' sot shumë normale, po në atë kohë ishte diçka e rrallë edhe sigurisht që tregon për identitetin tonë në të cilin ishim rritë ne familja.

Anita Susuri: A ka pasë shumë shqiptarë atje, a keni pasë lidhje me ta?

Nerimane Kamberi: Ka pasë, fatmirësisht, prapë po i kthehem domethonë këtij gurbetit. Kanë ardhë shumë shpejt familjarë të nanës, motrat e saj që ja kanë ndihmu edhe asaj për me kalu ma lehtë këtë largimin nga shtëpia, nga vendi. Shqiptarë ka pasë shumë, por ne sigurisht, sigurisht secili osht' marrë me familjarë të tij, të saj. Jemi taku në festa, sigurisht në festat e Jugosllavisë atëhere, në festat shqiptare tonat, në ndonji darsëm nëse osht' bo diçka. Po në shkollë ka pasë shumë pak të huaj, shumë, shumë pak. Tash osht' rritë numri, ne kemi jetu në një qytet të mirë, të vogël.

Por, edhe në univerzitet ku kam qenë, ka qenë univerzitet elitar. Arsyeja ka qenë, unë e kom pasë shumë afër, ka qenë një univerzitet jezuit, pra i udhëhequn nga priftërinjtë edhe kjo bën pjesë te kultura ime që jom rritë edhe në mes xhamisë dhe kishës, se në Preshevë e kom xhaminë te dera. Jom rritë me thirrjen e muezinit¹ të hoxhës. Kurse në Belgjikë gjithmonë e kam pasë shkollën edhe shpinë afër kishës edhe gjithmonë me zhurmën e kambanave, sigurisht me ritualet e shokëve, shoqeve atje, me vdekje, dasma e të tjera. Edhe kjo osht' ni pasuri shumë e madhe edhe në anën tjetër më ka mundësu ta shoh vendin tim edhe sigurisht që të merrem me vendin tim edhe ndryshe.

Anita Susuri: Më thatë që dy vite keni studiu pastaj keni ardhë në Kosovë?

Nerimane Kamberi: Po, po.

Anita Susuri: Në cilin vit ka qenë kjo?

Nerimane Kamberi: '87.

Anita Susuri: '87-a. Po në kohën kur kanë ndodhë, '81-tën për shembull demonstratat që kanë qenë, qysh ka reflektu te ju kjo?

Nerimane Kamberi: Domethonë, une i kom pasë, 14 vjeçare kom qenë, kur jemi kthi verës osht' folë, sigurisht kemi folë për atë. Nuk është që jemi marrë shumë me demonstratat e '81-ës, po sigurisht që e kemi bisedu në atë kohë. Por me përdorë një shprehje, me hy në zjarr të Kosovës, ka qenë kthimi '87 - '88, se ajo lidhet pastaj edhe me atë që ju thashë, unë veç isha e njoftun në Kosovë. Tash mos menoni si në nivel të sodit, por i njihshin shkrimet e mia edhe prapë domethonë shumë shpejt unë u lidha këtu me rrethe letrare, me rrethe gazetae.

Atëherë ishte "Zëri i Rinisë" ku edhe në kohën kur isha në Belgjikë, edhe kur patëm ardhë prej Belgjikës e pati organizu shkolla shqipe dy herë, dy vite rresht udhëtimin në Jugosllavi, sidomos në Kosovë, ku ne patëm ardhë te pishat e Deçanit si fëmijë të, të diasporës. Edhe ku u njohëm me vendin edhe atëherë u pata intervistë nga "Zëri i Rinisë" për shkrimet e mia dhe qysh atëherë veç fillova me hy në ato rrethe. Edhe fakti që unë folsha anglisht, frëngjisht, gjermanisht edhe qysh në momentin kur erdhën gazetarët e parë, unë fillova edhe të punoj me ta si përkthyes, m'i tregu për Kosovën.

Edhe normal punonim nganjëherë në kushte shumë të rrezikshme se ishte e ndaluar, u takojshim msheftas. Edhe unë prej Belgjikës u transferova drejt në Fakultetin Juridik, domethonë prapë ajo ide me studiu juridikun në Prishtinë. E cila ishte një përvojë jo e mirë për mu, kur e rikthej tash kujtesën nuk ka qenë sepse nuk jam pritë mirë, në kuptimin që ishte Jugosllavi, ishte socializëm. Disa profesorë

¹ Muezini është personi që jep ezanin në një xhami. Muezini luan një rol të rëndësishëm në sigurimin e një orari të saktë lutjesh për komunitetin musliman.

ma përsërisnin që, “Ti ke ardhë nga një vend...” Belgjika atëherë ishte edhe është mbretëri, ishte demokratike, ishte vend domethonë liberal, kapitalist.

Edhe sigurisht që sistemi juridik nuk ishte aspak i njejtë. Por në anën tjetër... domethonë nuk m'u pranuan fare ato vite [të studimeve], dhe fillova nga fillimi, nga viti i parë. Sigurisht që ishte komplet një sistem ndryshe i arsimimit edhe një mendësi tjetër në mesin e kolegëve, por edhe te profesorët mënyra e të mësuarit. Edhe shpesh herë qeshi se të kalosh prej jezuitëve te socialistët edhe te ni sistem socio-realist për do gjëra, ishte për mu shumë një, shumë një ndryshim i madh. Sigurisht që ka lonë pasoja, po edhe asja ju adaptova disi.

Kishte profesorë, unë tash vërtetë dëshiroj t'i përmendi, të cilët treguan shumë tolerancë, shumë mirësjellje. Ishte i ndjeri Bardhyl Çausi, i cili pastaj edhe me shumë keqardhje e kom kuptu që është vra në '99-tën nga sërëbët. Ai e jepte të drejtën romake edhe më tha, “Po, Nerimane e ke dhonë në Belgjikë e s'do ta japësh te une”. Edhe ishte diçka shumë përkrahëse. E kam pasë profesor Fatmir Sejdiun dhe madje kur më ka ndodhë shpesh të shkoj pastaj me përkthi nuk kam mund t'i them zoti president ,por gjithmonë i kom thonë zoti profesor. Edhe e disha që nuk po e respektoj protokolin, po për mu ishte një figurë vërtetë, i cili së pari edhe më pranoi.

Parameno unë isha 18-19 vjeçe në një vend komplet i huaj. I huaj në kuptimin që unë kam ardhë, po nuk e kom njoftë, kom ardhë në rrethe familjare. Shumë gjëra më janë dukë ndoshta ekzotike darsmat, veshjet e këto. Edhe po kthehemi 30 vjet përpara s'kanë qenë këto, këto mjetet e komunikimit të rrjeteve sociale edhe domethonë ishte një vend komplet i panjohur. Prishtina ishte në fillim kështu *friendly* [ang.: miqësor] anglisht ta përdori, edhe ja rifillova edhe aty ishte shumë interesant se pastaj mbaj në mend aty u vra një student. Na studentët këkrum një minut heshtje nga profesori, nuk na lejoi.

Edhe u kthejsha te ato edukata për të drejtat e njeriut që i kisha marrë në Belgjikë, Amnesty International, thojsha tash po e përjetoj së vërteti. Gjëra që kisha lexu, romane që kisha lexu në Belgjikë, tashti bëheshin realitet. Edhe ma herët thashë edhe në Preshevë ishin shkru grafite, janë arrestu të rinjtë që i njihsha, të cilët kishin folur. Kështu që, tash me të vërtetë kisha hy në zjarr edhe vazhdimisht frekuentojsja domethonë shokët të cilët ishin shokë të mi, ndër të cilët është edhe bashkëshorti im sot Hazir Reka. Ishim një grup atëherë të rinjë, një grup gazetarësh, fotografësh, intelektualësh edhe ishte një vazhdimësi e asaj që kisha nisë. Nuk u futa aty rastësisht, sepse njihesha si shkrimtare e re edhe ajo veç vazhdoi.

Edhe vazhdova me takime, me pjesëmarrje në krijimin e Forumit Rinor, e të Parlamentit Rinor, po pastaj vetë vendosa që kurrë të mos hyj në politikë, por e zgjodha këtë rrugën tjetër. Gazetaria, bashkëpunimi me mediat e huaja; qe 30 vjet bashkëpunoj me të gjitha mediat botërore, nga New York Times, kom fillu me New York Times në çajtoret e Podujevës, domethonë '89-'90. Për mua ka qenë shumë e rëndësishme të shohin se çka po ndodhë me Kosovën dhe në Kosovë. Edhe t'ua përcjellë në këtë mënyrë që për mu ka qenë më e dinjitetshme, ma e pafajshme me kontribu se... ky është

absolutisht mendimi im, se sa të hyj në ujëra shumë të turbullta siç është politika në Ballkan edhe pastaj politika në Kosovë.

Edhe kjo e shpjegon që edhe në luftë s'jom largu prej kësaj hapësirës domethënë edhe pse kom pasë mundësi, unë jom shtetase belge, të largohem në Belgjikë po gjithmonë kom dashtë që t'i përcjellë nga afër edhe sigurisht ndoshta edhe vendime të gabuara kom marrë rreth kësaj për luftë e tjerë. Po gjithmonë ajo ide që të përcjellë edhe të jam këtu. Gjithmonë e kam pasë atë ndjenjë që duhet të jem këtu çkado që të ndodhë, të mos e shoh nga larg ato çka po ndodhë me Kosovë. Kur flas për Kosovë, flas për të gjitha me Preshevë se... madje kur erdhët ju isha tu e korigju një tregim temin që ka të bëjë me luftë edhe me Preshevë. Kështu që, ajo kulturë ajo edukatë ka qenë edhe sigurisht mundohem që ta përcjellë te fëmijtë e mi.

Anita Susuri: Thatë që në vitin '87 keni ardhë, ka qenë një atmosferë shumë e ngurtë këtu në Kosovë sa i përket politikës, po du me ditë konkretisht si ka ardhë deri te angazhimi i ju për shembull te New York Times-i, si ka ndodhë qajo lidhje?

Nerimane Kamberi: Pra, ju thashë që unë fillimisht si shkrimtare e re fillova të shoqërohem, fillimisht u intervistova nga "Rilindja", nga "Zëri". Edhe bëra pastaj një përmbledhje me poezi që e tregonte këtë kohën time, të ardhjes time në Kosovë me gjithë atë bagazh që e kisha. Dhe unë shoqërohesha domethënë me gazetarë kryesisht të "Zërit". Të cilët sot jonë, dihet kush jonë, Blerim Shala, Halil Matoshi, Hazir Reka edhe me disa të tjerë. Edhe erdhi "Mladina" gazeta "Mladina" veç kishte fillu, që ishte shumë një gazetë alternative, avangard në Jugosllavinë e atëhershme, dhe ajo filloi me Kosovë. Se ndihej, dihej, ndihej se çka po bohet në ish Jugosllavi.

Dhe adresën e parë që e kishte, e kishte "Zërin e Rinisë". Normal, domethënë gazetarë me gazetarë. Kur erdhën, edhe ne u takuam me gazetarët e "Mladinës", të cilët ende i kemi miq. Edhe atyre ju duka si një personazh vërtetë i jashtëzakonshëm në këtë ambient, në këtë vend. Edhe thanë, "Të intervistojmë". Edhe unë thashë, "Më falni unë nuk jam shembull konkret i një vajze kosovare, une sapo kom ardhë". Mandej e kanë bo një reportazh, erdhën në banesë te unë ju duk interesant mënyra se si e kisha dekoru, librat që i kisha lexu.

Sllovenët në përgjithësi e kishin një imazh, jo vetëm të shqiptarit, të shqiptarit por sigurisht të femrës shqiptare, si një femër shumë të prapambetur. Si një femër që ka mbetë në shpi, që nga një anë e kom vërtetu edhe vet, se pastaj kemi punu me BBC-në në terren edhe jom çuditë, mundem edhe atë epizod t'ua rrëfej. Edhe unë refuzoja se e kisha një ide, thojsha, "Unë nuk jom imazhi i asaj femrës se nuk jom rritë këtu". Edhe pse në shpi, në familje jom rritë tradicionalisht. Baba jem, nana me ato vlerat të cilat na i kanë dhanë.

Por insistuan kështu që "Mladina" i pat katër apo gjashtë faqe intervistë me mu, që për atëherë ishte diçka shumë. Edhe shkruante "Shqiptarja e cila e lexon Marguerite Yourcenar". Marguerite Yourcenar

që ishte një ndër shkrimtarët më të mëdha femër, femra e parë në Akademinë Franceze. Edhe madje e futën një poezi timen të cilën e kisha shkru për femrën shqiptare edhe ishte ky imazhi tjetër, një imazh që donin ata ta tregojnë të femrës shqiptare, që edhe në Kosovë ka femra të atilla. Normal që ata kanë bo shumë reportazhe, po përmes meje donin ta jepnin një imazh tjetër edhe kur e mendoj tash ishte shumë e shumë e mirë, një iniciativë shumë e mirë si ide.

Dhe pastaj është shumë interesant se po i njeiti gazetar më ka përcjellë çdo dhetë vjet. Domethonë, kjo ishte '89-tën, '99-tën ai gazetari ishte, ishte korrespondent tani më "Mladina" ishte... se kishte mbaru lufta në Slloveni, ishte shndërru në "Delo". Ai erdhi prej Izraelit me përcjellë Kosovën edhe na gjeti disa personazhe tyne edhe...

[Këtu ndërprehet intervista]

Ne ishim refugjatë, domethonë ne ikëm nga Prishtina edhe ishim refugjatë në Shkup edhe na gjeti edhe bëri intervistë me mu. Edhe më tha, "Nerimane, çka ke bo këto dhetë vite?" Edhe thashë, "E kom bo ni fëmi" s'di qashtu osht' në intervistë, "kom kështu, kom pregaditë me hongër, kom studiu edhe e kom pa rrënimin e Jugosllavisë". Edhe më tha, "Çka ke bo, si ja ke bo me mbetë kaq e bukur në kohëra kaq të vështira?" Edhe osht' e vërtetë kur e shoh fotografinë teme në atë intervistë jam shumë e bukur, pa modesti.

Në kuptimin, pastaj i kuptojsha të gjitha reportazhet që i kom lexu për femrat në luftë, se mundohesh së paku te une në mënyrë ta pavedijshëm të tregohesh që je gjallë, që je e bukur, që jeta vazhdon, që je nanë e mirë, gru e mirë. Edhe domethonë e lidhi, pa modesti, është e vërtetë po shikimi im, fotografia ka dalë që ta tregon gjithë atë shikimin edhe është dëshpërim edhe është oqean ku mund të zhytesh, edhe dëshprim çka na ka ndodhë edhe nga ana tjetër plot shpresë. Edhe titulli edhe ajo domethonë më emocionoi. Titulli është "Nerimane Kamberi shkrimtare dhe refugjate".

[Këtu ndërprehet intervista]

(Flet e përloitur) Ishte domethënë diçka për mu, dyjat ishin shumë fshtirë edhe pse normal tash me këto vite me studime, edhe me punën e di që shumë shkrimtarë e kanë kalu një fazë të jetës edhe e kanë shkru. Edhe pastaj i njeiti gazetar pas dhjetë vite, 2008-tën, 2008-2009 ka ardhë për pavarësi të Kosovës më ka intervistë, edhe mas dhetë vite 2018-tën, dhetë vjetorin e pavarësisë më ka intervistë. Edhe shumë interesant se përmes asaj interviste e shoh edhe rrugëtimin e Kosovës bashkë me mu ose mu bashkë me Kosovën.

Kjo domethonë ka qenë ajo për të cilën më pytët, gazetarët që vinin adresën e kishin "Zërin", e kishin "Rilindjen". Edhe une ndonëse isha edhe flitja disa gjuhë edhe isha në atë rreth edhe ashtu fillova, domethonë me mediat e huaja, të bashkëpunoj edhe të shkonim në terren. Aty kisha plotë përvoja, kur

jom arrestu pikërisht në “Trepçë”, pak frika, pak euforia, pak adrenalina të gjitha këto për të cilat mund t’ju flasin, kur flitnim me gazetarët në terren, gjithmonë e kemi pasë, dhimbja sigurisht.

Kam punuar pastaj një dokumentar, kom punu shumë në këto çështje, që duhesha ta ceki me këtë statutin dhe pozitën e gruas të cilën “Mladina” mundohej ta tregonte ndryshe me reportazhin që e bonin me mu me artikullin. Ne bëmë një film të gjatë për BBC-në, që kishte për temë pajtimin e gjaqeve jo, më falni, hakmarrjen. Edhe ne kërkonim njerëz në terren ku unë isha asistente vendore edhe përkthyste edhe kërkonim familje ku ne do të xhironim.

Ishim në shumë vende në Kosovë edhe ishim në shumë vende në Kosovë. Edhe ishim në Drenicë edhe shkumë me një familje. Vajzat e asaj familje kishin ndëgju që shkrimtarja Nerimane Kamberi është aty. Vërtetë për atë moshë isha si një fenomen prapë në thonjëza, për mu që më kishin qujt. Po ato vajza tash nuk kishin të drejtë me ardhë në odë, neve na futën në odë sepse na konsiderojshin si të huja, ishte regjisorja Melisa Leville, një angleze. Ishte asistentja angleze edhe unë, domethonë ishim tri femra edhe na u leju të hyjmë në odë.

Por atyre vajzave nuk ju lejohej që të vijnë por ato, “Ta takojmë Nerimane Kamberin”. Edhe disi për mu ishte e pakuptueshme që në atë kohë të... edhe pastaj unë shkova i takova, te pjesa, te shpia ku ishin femrat. E ma dhurun një punëdore, një tentene që e kom ende, si shenjë miqësie me to. Kështu që, çdo herë edhe në këtë anën edhe kur punojshim sikur në rastin e hakmarrjes e këto, një ndër punët që mundohesha të bëj përveç përkthimit, mundohesha ta luaj pak edhe rolin e historianës, etnografës, antropologës amatere kuptohet.

Duhej të përgaditesha shumë sepse mos ta kenë atë imazhin gjithmonë sikur hakmarrja që ne jemi një popull shumë i prapambetur, shumë i egër e tjerë. Normal që unë edhe nuk kisha nevojë të, të, të gënjejë, ajo që ishte shihej. Ishin njerëzit aty për me shpjegu, ishte profesor Anton Çetta me të cilin punonim, të cilin e kemi xhiru në dokumentarin tonë, ishte hoxha i Bubavecit, ishte Don Lushi, që ishin figurat apo arsimtarët të vendeve ku ishim që ja shpjegonin gjanat. Por, sigurisht në bisedat tona me ekipin gjithmonë duhej të shpjegoheshin.

Sigurisht edhe letërsia më ka ndihmu shumë me referencat letrare e tjera, gjithmonë që Kosova ta ketë imazhin, një imazh real. Po normal as ta shtremnoj se ishte çka ishte prapambeturia ishte ajo që ishte, por gjithmonë t’ia shpjegonim ndoshta edhe arsyet pse kishim mbetë na ashtu. Edhe këtë kom vazhdu edhe sot, vazhdimisht kur takohna edhe si profesorëshë edhe si gazetarë, reportazhet e mija domethonë, librin që e kom bo si gazetarë, para dy vjetëve flasin për Kosovën, ashtu si sigurisht siç është me shikimin tim, si e shoh unë, po ashtu si dua t’ju tregoj të tjerëve.

Anita Susuri: Si e kuptonin ata të hujtë për shembull gjakmarrjen, si reagonin?

Nerimane Kamberi: Shihni unë gjithmonë them, e kam pasë fatin që të punoj me gazetarë shumë profesional. Shumë profesional në kuptimin që kanë ardhë të pregaditun, kanë lexuar shumë. Por ata sigurisht e kanë pasë idenë e tyre çka, qysh e kanë mendu. Edhe sigurisht që personat të cilët i kanë takuar, qoftë sërbe, qoftë shqiptarë, qoftë intelektualë, qoftë bujkë e tjerë. Ja kanë pasuru, ja kanë deformu atë imazh. Por, prapë, domethonë, kanë qenë gazetarë të cilët kanë lexu e kanë kuptu.

Po unë edhe me televizion kam punu shumë, jo vetëm në terren po edhe me montazherin kom punu, këtë filmin, këtë dokumentarin për Kosovë, se kom punu në dy dokumentare shumë të mëdhaj, në 20 vjet dallim. Për këtë kam qenë edhe në Londër, me përkthi filmin, pastaj edhe me punu me montazherin. Edhe e dini edhe ju vet punoni domethënë në këtë lëmi, janë disa etapa prej gazetarit, monta... plus ne, ajo koha e BBC-së ishte koha e artë e gazetarisë, ku ishte një mega ekip që pat ardhën.

Regjisorja ma e mirë angleze, kameramani ma i mirë në botë, tonisti ma i miri në botë. Ishim nja dhetë veta në ekipë. Edhe kështu që kalohej përmes disa hallkave të zinxhirit edhe deri te montazheri po gjithmonë me pasë atë... Edhe e ripashë atë filmin para dy vjetëve në Dokufest, se gjithmonë kisha frikë që mos po e japin ni imazh të keq, ni imazh të gabum. Jo që mundohesha me bo makijazh, a din me ndryshu. Po ishte që doja të tregohej realja edhe sidomos të kuptohej pse jemi këtu, e pse jemi të atillë. Çka na kish ndodhë, çka s’kishmi pasë që me mbetë, me ardhë në një gjendje të tillë.

Edhe që e ceka që jam gazetare në një portal frankofon “Le Courier des Balkans”, pikërisht këtë verë e kemi serinë e shkrimeve për përfundimin e Jugosllavisë edhe quhet “Vera e fundit e Jugosllavisë ‘91”. Edhe prej të gjitha vendeve ku jemi korrespondent e rikujtojmë edhe kjo është shumë e rëndësishme për të rihtë. Edhe unë thojsha që shpresoja që do ta bëj një libër siç e kemi bërë më herët. Unë kom kontribu për Prizrenin domethonë, qytetin e vjetër e kem bo ni libër sepse kjo është historia e jonë e ish Jugosllavisë edhe e kupton pse erdhëm deri te kjo, pse erdhëm deri te luftërat, pse, çka ndodhi.

Kemi fillu me ni intervistë me presidentin Milan Kučan, slloven edhe vazhdojmë deri shtatorin e ‘91-shën që përfundoj une me Kosovë. Kështu që, ajo që gjithmonë më ka shty edhe sigurisht të punoj vet si gazetare, osht’ edhe puna me gazetarët, po edhe ajo që të tregoj diçka.

Pjesa e Dytë

Korab Krasniqi: Thatë që jeni kthi në ‘87-tën, keni qenë e re, 14 vjet, sa?

Nerimane Kamberi: Jo ‘87-tën kom qenë...

Anita Susuri: 18 vjeç.

Nerimane Kamberi: Po 18 vjeçare.

Korab Krasniqi: Qysh e keni pa domethonë, e përmendët edhe ma herët domethonë keni shku në Belgjikë, jeni rritë, keni fillu edhe shkollimin atje, Jugosllavia për juve çfarë projekti ka qenë, qysh e keni pa idenë e Jugosllavisë? Ndonëse '87-tën situata ka fillu pak me eskalu, qysh e keni pa ju Jugosllavinë atëherë?

Nerimane Kamberi: '87-tën tash të jemi të saktë i kom pasë 20 vjet, se sigurisht edhe emocionet na hupin matematikën. Shikoni, tash për mu, unë e kom ndi veten si shqiptare e Jugosllavisë, s'e kemi pasë kurrë atë idenë shqiptare e Shqipnisë. Ne kemi njoft njerëz të cilët e kanë pasë një iluzion të Shqipërisë të Enver Hoxhës, si ajo, si parajsa në tokë, ne jo. Vërtetë ne kemi qenë shqiptarë, jemi rritë siç ju thashë me ato vlerat, flamurin shqiptar. Unë e di se në Preshevë kanë qenë familjarët e mi të parët që e kanë qit flamurin, di shokë që janë burgos për atë flamur.

Edhe une e përsëris shpesh në biseda familjare edhe me miq kur jemi martu, Kosova ka qenë ende në Jugosllavi në '94-tën, po ka pasë postblloqe edhe kur kanë ardhë krushqit nga fshati, nga Nerodimja me më marrë mu në Preshevë, ja u kanë ndalu flamurin. Edhe axha i burrit që ka qenë ni burrë i fisëm, shqiptarë me plis edhe bajraktarët kanë fillu pothujse të kacafyten aty me policë. Ju kanë thonë, "Ne nuk marrim nuse pa flamur". Edhe gjithë them që jam lidhë me atë idenë edhe pastaj normal kanë ardhë në një ujdj që, "Palone flamurin kur të vini te shpija, nusës ja vini te dera, e paloni prapë e kështu".

Por, prapë, domethonë ajo ideja e Jugosllavisë si një entitet, si një vend ku ka pasë... ju thashë ne jemi konë në shkollë shqipe. Dy vite kemi ardhë në ekskurzion, ku jemi ndalë në Slloveni, kemi shku në Sarajevë, në Kroaci. Unë daj të i kom pasë në Maqedoni, në Kumanovë edhe maqedonishtja ka qenë ni gjuhë që e kom ndëgju. Normal, s'e kom ditë as sërëbishten, po e kom mësu cirilikën përmes grafiteve, lajmërimeve e tjera. Nuk ka qenë absolutisht diçka që kemi refuzu, po tek domethonë ma vonë 18 vjeçe, kur kam fillu mu pjekë edhe intelektualisht, e kom kuptu që kjo Jugosllavi ka qenë Jugosllavi shtypëse.

Por, në atë kohë domethonë kemi qenë shqiptarët e Jugosllavisë, shqiptarët e Preshevës, e tjera, edhe e kemi pa si diçka pozitive. Pastaj vërtetë fillimi, kur jam kthi në Kosovë edhe kur e kom pa komplet këtë rënie, kur jemi taku me sllovenë, me kroatë. Faktikisht ne kemi qenë në Kroaci në vizita edhe te gazetarët tanë në përfundimin e Kroacisë. Mbaj në mend një historiane që thoshte s'duhet të vije Tuxhmani në pushtet se ka me përfundu Kroacia. Domethonë, shumë vonë e kom kuptu kaq thellë domethonë. Fillimisht e kom pasë idenë që shqiptarët s'kemi pasë të njejtat të drejta që kemi qenë ma të varfër. Kosova ma e prapambetur ekonomikisht, po sigurisht që ma vonë e kom kuptu.

Anita Susuri: ‘89-tën ka pasë shumë ngjarje të rëndësishme historike në Kosovë që kanë ndodhë edhe njona prej tyre ka qenë edhe greva e minatorëve, ju thatë që jeni angazhu në qat drejtim në gazetari. Po më intereson krejt qajo qysh ka ndodhë, si e kujtoni qat periudhë?

Nerimane Kamberi: Është interesant se prej momentit që Korabi, kolegu juj më ka propozu jom mundu shumë shpesh me rikujtu këto edhe ndoshta shumë ma pak edhe në Kosovë jemi marrë me këtë. Janë dy epizodat shumë me të cilët ma pak osht’ marrë Kosova ndoshta për shkak që jemi fokusu në luftë. Ka qenë kjo çështja e pajtimit të gjaqeve që ka qenë në ngjarje shumë e madhe, shumë e madhe edhe sigurisht po e shohim çdo ditë e ma shumë efektin edhe impaktin që e ka pasë. Edhe kjo greva e minatorëve. Edhe u mendojsha kujtesën për me mbajt në mend, domethënë kujtesën ma shumë e kom qindra studentë në sallën që tash quhet “1 Tetori” dhe unë që mbajta fjalim edhe po e shihni që për nga natyra jam shumë emocionale.

Po edhe vizita te minatorët, domethënë edhe aty tregon që ka qenë në moment ku jemi bo bashkë edhe kjo lidhet me, me, me takimet, me miqësitë që kisha une me gazetarët e “Zërit” edhe me intelektualët e rinj të asaj kohe. Edhe kur fillun studentët që të solidarizohen në shkurt, ishte ftohtë, të solidarizohen me minatorët sigurisht që une u lidha me grupit e studentëve edhe u futëm në sallën “25 maj” të asaj kohe. Edhe mbaj në mend që ne rrinim në atë kohë, isha afër me Afrim Zhitinë, i cili është vra nga serbët ma vonë. Edhe domethonë solidaritetin edhe të popullsisë për të na sjellë bukë studentëve, sepse minatorët ishin në zgafella me ne aty po të na sjellin diçka për me hongër aty.

Edhe u zgjodha, une mendoj që... domethonë tash nuk di, nuk kom hulumtu kush e mori vendimin që unë të jem aty. Po sigurisht, ishte edhe Baton Haxhiu në atë kohë që ishte student. Ishte pse u përzgjedha ma merr mendja ishte që isha prapë ajo figura ndryshe, ai personazhi ndryshe. Isha shkrimtare e re, simbolizojsha, kishte shumë pak femra shkrimtare në atë kohë, sidomos të reja; që kisha ardhë nga jashtë, që bartja vlere iluministe të filozofëve të shekullit XVIII francezë. Edhe domethonë u përzgjedha në atë mënyrë që të shkoj të përfaqësoj studentë në minierën e “Trepçës”.

Anita Susuri: Keni qenë grup apo...?

Nerimane Kamberi: Jo, kemi qenë një grup, jo një grup studentësh, një grup, thashë ka qenë Batoni, kam qenë unë, nuk di, shumë pak më kujtohet, jam mundu i gjeta disa arkiva. Edhe ne shkum atje, zbritëm në zgafellë edhe nga arkivat mu rikujtu por edhe mbaj në mend që ishte shumë emocionuse, shumë... sepse ata ishin nguju aty poshtë për Kosovën. Mos të harrojmë pastaj se vinin lajme të ndryshme. Ne ishim bërë sy e vesh për vendimet që do të merreshin për Kosovën edhe vishin lajme të ndryshme. Kështu që, ne ishim pre faktikisht edhe të atyre që sot do t’i quanim *fake news*, lajme të rreme të atëhershme. Edhe ishte domethonë një tension vërtet shumë i madh.

Pastaj ishte edhe rreziku në çdo moment që mund të futeshin në sallë. Paramendoni ne ishim në një hapësirë të mbyllur aty që serbët mund të futeshin edhe te studentët t’i arrestonin në masë, të

përdornin dhunë. Kjo ka mund të ndodhë, po ajo euforia prapë, ajo adrenalina, ideali edhe solidarizimi që kishim ne me minatorë na bënte që ne do të shkonim deri në fund edhe vazhdimisht këtë e përcillnim. Edhe te minatorët ja përcolla imazhin, atë mesazhin e studentëve që ne solidarizohemi, që jemi me ta. Edhe e mbaj në mend, po edhe arkivat ma përkujtun që vërtetë edhe aty kom qajt se ishte shumë e randë. I shihnim edhe disa ishin vërtetë në gjendje të randë.

Edhe kur u ktheva atë e mbaj në mend shumë mirë, unë e mora fjalën, prapë sigurisht them si femër po mendoj, si shkrimtare e re, si studente e Universitetit të Prishtinës. Edhe e citova, ishte citimi i Ana Frankut që thoshte, “Më mirë një fund i tmerrshëm se një tmerr i pafund”. Edhe ja përcolla mesazhin minatorëve që ishim me ta, që falenderonin. Edhe vërtetë ishte një moment, një moment shumë i madh, shumë i fortë. Nuk zgjati, ajo grevë ishte një javore. Mbjaj në mend që pastaj u rrezikim, baba jem erdh me më marrë se frigohej se kishte pa në lajme që pytyshin. Madje kishin thënë, “Kush është kjo belgja në mesin e studentëve në minierë?” Ai kishte frikë për mu, po une refuzova të largohem prej Prishtinës. Nuk pata pastaj ndonji problem, ndonjë arrestim.

Anita Susuri: Deshta me ju pyet diçka para se me vazhdu. Çfarë imazhe ju kujtohet, nëse mundeni me na përshkru? Si e kujtoni?

Nerimane Kamberi: Kujtesa, ju thashë nuk jam marrë shumë edhe vet me këtë moment se ‘99 më ka lonë pak ma shumë, se edhe osht’ pak ma afër. Po unë e kom këtë shqip i thojnë, frëngjisht i thojnë *une mer de jeunes*, domethonë {hap duart} një det me njerëz. Gjithë ata studentë ishim të ulun, e mbaj në mend Afrimin, ndoshta e kom fiksu ma shumë se pastaj u vra, tash osht’ dëshmor i Llapit edhe atë valën e njerëzve. Edhe gjithmonë atë ndjenjën që po jetoj *live* [drejtëpërdrejtë] diçka që kisha lexu, për të cilën kisha nënshkru peticione në Amnesty International. Për mu si një vajzë me një kulturë perëndimore të atëhershme imazh ka qenë gjithmonë Mandela. Po përjetoja diçka *live* ishte një aparteid te ne, ishte Adem Demaçi, ishin këta studentë.

Prapë unë po thom e kisha idenë, grevat e studentëve ‘68-tës në Paris, që normal e kishin një dimension tjetër. Ato imazhet i kisha fiksu edhe normal historinë tonë dhe tani i përjetoja *live*. Ishin domethonë ajo... une tri momente i kom të fiksum, osht’ ai det me të ri, me studentë, fjalimin tim e mbaj në mend që me drejtë kështu mbaja edhe unë në minierë me shlemin apo helmetin e tyre, e minatorëve. Edhe ku isha shumë e emocionume, ku qaja t’i shoh ashtu. Jonë ato tri imazhet ishte, ishte vërtetë ftohtë ishte shkurt. Këto tri imazhet i kom. Edhe kur nuk jom ndalë me mendu pse unë, po besoj që kjo është arsyeja se e kisha një emër atëhere edhe shumë të ri më njihshin, shumë studentë, shumë...

Siç ju thashë midis Drenicës ato vajzat, sepse atëhere punojshim, domethonë “Zëri” shkante në çdo vend. Shkante në shkolla, televizioni, nuk ishin në masë kaq të madhe si sot. Edhe ishim të paktë, une faktikisht isha e para që kisha shkru plus në gjuhë të huaj, në një stil tjetër, në një zhanër tjetër. Edhe e kisha një emër, e përfaqësoja domethonë studenten shqiptare, studenten e UP-së. Kulturë

perëndimore, angazhimin qysh atëhere me gazetarë, me shkrimtarë edhe ka vazhdu kështu deri, deri të gjitha peripetësitë. Se pastaj edhe u helmova kur u helmun të rinjtë, përfundova në spital, kur u helmun të rinjtë e Kosovës.

Anita Susuri: Deshta edhe pak me u ndalë, pastaj vazhdojmë andej edhe për pajtimin e gjaqeve sepse janë vitet '90.

Nerimane Kamberi: Po.

Anita Susuri: Deshta me folë edhe pak për grevën. Thatë ma herët po më duket për arrestimin diçka.

Nerimane Kamberi: Po, jom arrestu domethonë, jom marrë në pyetje, në bisedë informative se punoja me një televizion francez edhe neve na interesonte, na interesonin minatorët, kushtet e minatorëve. Ishte '88-ta, '89-ta edhe shkum atje, po në atë kohë duhej me marrë një leje që quhej Ministria e Informimit atëhere. Edhe sigurisht që ata e morrën edhe unë nuk e morra se nuk ta jepnin. Edhe shkumë edhe une thashë, "Po bëhem franceze", e mora një emër francez, folsha frangjisht edhe ata thanë, "Ku e ka kjo lejen me punu?" Ata thanë, "Nuk ka" a din, "e ka harru në hotel" edhe nuk na lejun më vazhdu.

Edhe ditën e dytë i njejti skenar edhe tash unë u dashtë m'u demasku me thonë që jam shqiptare e kom emrin kështu edhe policë kishte shqiptarë, kishte sërëbë edhe thanë, "Ti do të vish në bisedë informative". Edhe nifare, tash po e karikatroj po tërheqnin ata {lëviz nga njëra anë në tjetrën} tërheqnin këta. Gazetarët thojshin, "Nuk e lejojmë, kjo është me neve! Nuk e lejojmë që ta merrni në bisedë informative. Pytnani neve çka doni". Edhe policët prapë tërheqje, pra po karikatroj {bën thonjëzat me gishta} se fizikisht jo.

"O nuk i bojmë kurgjo vetëm..." edhe arritëm në një kompromis, në një marrëveshje. Ata thanë, "Nëse ju intervistoni e merrni në pyetje na rrimë te dera. Në momentin që ndijmë diçka e thejmë derën". Kështu ka qenë shumë e qartë ni rrahje, ni shuplakë çkado se ata sigurisht mendonin, po edhe unë se tash po më doket lehtë po nuk u konë lehtë. Se thanë, "A ti Nerimane, a dje e kishe emrin Mary Francoise, a diçka frangjisht?" Edhe kaloi domethonë pa ndonji dhunë fizike. Normalisht ishte frigë, çka po lypim, pse po lypim. Unë thojsha, "Po na interesojnë minatorët çfarë kushte po lypin" ishte me kushte të mjerushme jetesa e tyre.

Anita Susuri: Ishte para grevës kjo?

Nerimane Kamberi: Po, po, po ishte para grevës, ishte para grevës.

Anita Susuri: A e keni ditë ju që ndoshta po planifikohet ndonji grevë edhe pse nuk ka qenë...

Nerimane Kamberi: Jo, jo. Jo, jo, jo, jo s'kemi, nuk kemi ditë.

Anita Susuri: Po kur ka ndodhë kjo greva çfarë mendimi keni pasë ju, qysh ka me përfundu, a keni imagjinu diçka?

Nerimane Kamberi: Ju thashë, na të rinjtë merrnim lajmet, tash studentë, sigurisht, përfaqësus që ishim, merrnim lajme të ndryshme që po i pranojnë kërkesat e minatorëve, i pranuan, u mashtruan. Kështu që, vërtetë asgjë konkrete nuk kishim veç ishim të vendosur që të shkojmë deri në fund që sa të shkojnë minatorët të shkojmë edhe na. Domethonë, në asnjë moment ne... nuk ishte greva jonë, ishte greva e minatorëve të cilën ne e përcillnim, e përkrahim.

Solidarizoheshim me ta, por ne ishim të vendosur, çkado që ata do të bënim ne do ta përcjellnim edhe ishim të, të një mendje edhe kjo ishte domethonë. Sigurisht edhe në mesin tonë kishte ma të mëdhaj që kishin përjetu '81-shën, edhe nga ajo që dinim për statutin e shqiptarëve, sigurisht që s'kishim naj shpresë që do të ndodhte diçka shumë më e mirë për ne. Por, ishim të vendosur sepse e dinim që do të humbnim shumë po të lëshonim pe.

[Këtu ndërpritet intervista]

Sigurisht që studentë që kanë qenë ma... sigurisht që ka pasë organizata të studentëve, sigurisht që ka pasë ilegale aty. "Zëri" ka ardhë, tash unë nuk po them që kam qenë organizatore edhe nuk kam qenë në ato qarqet atëherë, po une veç e kom përcjellë këtë valën e madhe që veç thashë që të marrim pjesë edhe të shkojmë të gjithë në sallën "25 maj" atëherë. Vizita ime... mu po më vjen keq nuk më kujtohet, ka sigurisht njerëz që kanë me sqaru këtë ma mirë se unë. Po sigurisht ka qenë dita e dytë, dita e tretë se deri sa ka fillu ajo grevë, deri sa e kemi pa se si po zhvillohen gjërat. Por ne deri në fund, në momentin kur kanë dalë minatorët edhe ne jemi shpartallu.

Korab Krasniqi: Ju e përmendët që e keni pasë një fjalim në sallë. A të kujtohet çka keni thanë, a të kujtohet qysh jeni artikulu, çfarë mesazhi keni bartë?

Nerimane Kamberi: Ju thashë ka qenë një fjalim emocionus po ajo që e përmenda është ajo thënja e Ana Frankës, sepse ashtu e përjetova. Ishte vërtetë një fund, në kuptimin, edhe fund i minierës, ishte një metaforë e kësaj, fundi i Kosovës, të përfundoj, edhe përfundoj tmerrësisht me luftë po ishte ajo ideja e zgafellës edhe fundi tmerrshëm. E kjo m'u ka ngulitë edhe e di që shumë e kanë mbajtur në mend, se më vonë me disa vite njerëzit që më kanë pa, "A jeni ju që e keni thënë këtë? Nuk e harroj".

Edhe kush më tha një ditë... Po ishte një diplomat i joni, sot nuk e di as cili se nuk pyta shumë që kish thonë, "A po e njihshi Nerimane Kamberin, ku gjindet ajo?" Se unë as në rrjete sociale s'jom kështu. "Ku është ajo se e mbaj në mend si kur ka shku në minierë edhe fjalimin e saj". Kështu që, mu po më

vjen mirë që paska pasë... sigurisht shprehja atë që e kom ndje edhe ato që e kanë ndi studentët. Por edhe ishte një privilegj shumë i madh për mu që të futesha në minierë edhe t'i takoj.

Korab Krasniqi: Çfarë atmosfere e gjete në minierë, kon e keni taku?

Nerimane Kamberi: I kemi taku domethonë minatorët të cilët ishin aty, në gjendje të lodhur. Në gjendje... sepse ishin në terr që sa kohë ishin pa ushqim, po ishin edhe me një mision të madh edhe nuk e dinin as vet se si do të rrjedhte pastaj për ta. Emra konkret nuk kam, po për mu janë minatorë domethonë s'e kom hulumtu as vet, ndoshta s'e kom pasë atë kureshtjen sepse për mu kanë simbolizuar çdo minatorë që ishin aty. Pastaj, sigurisht që ka qenë për mu si një lehtësim kur i kemi pa, kur kanë dalë prej minierës që ja fshehin sytë {vendos dorën para syve} ja mbyllin sytë për shkak të dritës.

Ka qenë në moment shumë i madh dhe jonë domethonë... Ju thashë unë funksionoj shumë me imazhe ndoshta edhe me punën edhe televizionet po edhe shkrimi. Janë ato tri imazhet, është imazhi që thashë i studentëve të salla "25 maj" me qindra studentë. Te ngjarjet pastaj është imazhi i Bllacës që ma kujton, domethonë ai tmerri jonë, mijëra njerëz. Edhe sigurisht ato s'i kom pa, po e kom kriju atë imazhin e mijëra njerëzve që i kanë shty në tren, që t'i kujtojnë edhe luftërat tjera. Kështu për mu është ajo një masë e madhe njerëz, solidarizimi i madh edhe pastaj greva që e kemi bo, marshet që i kanë bo grate, buka për Drenicë, qirinjtë edhe nëse vërtetë do të donim ta kishim një fjalë kyçe, një *key word* është masa, gjithmonë është masa, masa, masa.

Anita Susuri: Edhe diçka po më intereson në lidhje me grevën, po nuk e di tash a ju kujtohet. Është procedura para se me hy në zgafellë, sepse minatorët nuk e kanë pranuar gjithë aty, po kanë qenë vetëm ata që i kanë zgjedh vetë, dehe juve ju kanë pranuar. A ju kujtohet kush ka qenë për shembull në hyrje, si ju kanë pranuar?

Nerimane Kamberi: Jo, vetëm se pranimi, ata nuk kanë pranuar, nuk kanë pranuar sigurisht se jonë frigu që do t'i mashtrojnë, do t'i manipulojnë, që do të merr një kahje tejet politike greva e tyre. Por, studenti për ta, mos të harrojmë që studenti gjithmonë e ka pasë vendin e vet, vlerën e vet, gjithmonë. Ka qenë edhe në Jugosllavi, "A studenti" mos të harrojmë tash kjo bën pjesë të kujtesa kolektive, studenti osht' ai që e ka çu flakadanin te Tito, te Tita atje, studenti, nxanësi, sepse kemi qenë në një kohë proletare. Ka qenë studenti, minatori, punëtori. Ka qenë Jugosllavia socialiste.

Por edhe univerziteti i Prishtinës është çelë shumë vonë, mos të harrojmë, e drejta për arsim është bo shumë vonë, te femrat sidomos. Dhe për atë ju thojsha, jom mundu me ju spjegu edhe tjerëve edhe të huajve ndesh gazetarë, ndesh diplomatë që ne kemi pasë të drejtë shkollimi shumë vonë. Ku në univerzitete ku kom studiu kanë qenë qindra vjeçare. Ne i kishim domethonë '89-tën sa i kishim as 20 vjet s'i kish UP-ja. Edhe studenti ka pasë një vlerë të madhe sepse me folë me fjalë të atëhershme e ka simbolizuar arsimin, përparimin, dritën edhe minatorët edhe e kanë ditë që na po solidarizohemi me ta.

Nuk ishim as politikanë ne, nuk ishim as drejtorë, të “Trepçës” e... normal, pastaj ata ishin drejtorët, mos të harrojmë ishte Burhan Kavaja e të tjerët. Ne nuk përfaqësonim asnjë pushtet, ne ishim studentë ishim me ta edhe e përfaqësonim univerzitetin; që ishte një arritje e madhe e Kosovës në ‘70-tat që ishte faktikisht kur t’i kthehemi vitet më të qeta, po edhe më përparimtare për Kosovën deri domethonë me Kushtetutën e ‘74-tës. Ne kemi pasë ato pak vite, se ‘68-ta, pastaj ‘81-sha rifillon ato pak të ‘70-tat edhe sigurisht ata na kanë pritë me shumë mirësi, S’kam pasë asnjë dyshim për atë.

Anita Susuri: Osht’ e logjikshme se njona kërkesë e tyne ka qenë mospensionimi i hershëm i profesorave, arsimtarëve, mësimdhënëse...

Nerimane Kamberi: Po, po, po, absolutisht, absolutisht. Edhe sigurisht ata kur kanë filluar atë grevën edhe kur të gjithë shqiptarët jemi mobilizu. E kemi ditë që një nga pasojat do të ishte mbyllja e univerzitetit edhe ndodhi ashtu. Na u mbyll univerziteti, na u mbyllën shkollat edhe kështu që studenti ishte përkundrazi shumë i mirëseardhur te minatorët.

Pjesa e Tretë

Anita Susuri: A keni arritë me diplomu ju para mbylljes?

Nerimane Kamberi: Unë kom diplomu në paralel. Faktikisht ishin vitet e fundit, sepse siç ju thashë e rifillova, e rifillova fakultetin. Por, pastaj, sigurisht që magjistraturën e kom kry në sistemin paralel “Shkup e Shkodër” (qeshë), nga një kodër e Prishtinës në një kodër tjetër.

Anita Susuri: A mundeni me na folë pak për këtë periudhë?

Nerimane Kamberi: Domethonë isha, domethonë isha studente e re, bëja magjistraturën edhe shkonim domethonë te Katër Llullat ishte një shpi e vjetër, mësonim për filozofi. Tash kur e menoja shumë surrealistë (buzëqeshë). Për filozofi ekzistencialiste ndër të tjera, në një shtëpi të vjetër e cila sot më nuk po ekzistojka. Edhe tash te kjo pjesa si e qujmë ku është edhe “De Rada” ku kush, që thojnë kush bojke rahmet (qeshë) me na e lonë një vend, e kush na jepte një vend.

Po ishte një mësim shumë i, shumë efektiv, kam pasë domethonë profesorë Rexhep Ismaili, Sabri Hamiti, profesor Metaj, profesor Stavileci, ishim një grup i vogël studentësh të magjistraturës. Domethonë, edhe ishte edhe s’ishte univerziteti sigurisht që nuk e ndjenim atë, por me rëndësi ishte dija, dija të përcillej se ku ndodheshim jo që s’kishte rëndësi sepse do të kishim pasë dëshirë me qenë në fakultet, po dija që të përcillej edhe përcillej mirë. Mbanim provimet edhe... po pastaj u shkëput, ndodhi lufta edhe diplomova.

Korab Krasniqi: A ju kujtohet objekti ku e keni kry shkollën, qysh osht' dokë objekti, qysh osht' organizu funksioni objektit, qysh janë organizu ligjeratat?

Nerimane Kamberi: Tash unë i kom dy, dy pjesë, ni pjesë ku unë vet kom qenë asistente e re. Te Katër Llullat gjithashtu e kemi pasë ni shpi të vjetër me ni kaftor të vogël edhe studentët. Një ditë i kom gjetë shënimet ku jepja mësim aty. Edhe në Dragodan ku kam dhonë mësim domethonë në Arbëri, në një shpi të një shqiptari, ku zbritej shkallëve, sikur tash banesat që po i marrin studentët me qira, zbritej shkallëve, ishte një dhomë mbrapa shpisë. Kurse ne si studentë të magjistraturës ishte ajo shpija te Katër Llullat, si duket tash është bo ndërtesë e lartë edhe ishte përballë "De Radës" tash është një rrugë e vogël sa e mbaj në mend, ka qenë një kat nalt i një shpije edhe aty kemi mbajt domethonë ligjeratat me rregull, me orar të rregullt.

Po mësimi ka qenë, kur jepja mësim unë ishte diçka ma interesant se ta fillojsh ti karrierën si akademike me dhonë mësim nëpër podrume ishte një djenjë e rondë sigurisht. Edhe gjithmonë ajo që më ka bre osht' edhe sa? Edhe sa? Sa kështu? Sa do të zgjasë? Sa do të zgjasë kjo? Sa do të zgjasë lufta? Sa... ajo që kërkush nuk e din, po që edhe tepër zgjat, tepër zgjat se osht' diçka që tham edhe ma herët, që ti e bartë gjeneratë mas gjenerate. Kjo ka ndodhë me stërgjyshin, kjo ka ndodhë me prindin, kjo ka ndodhë me ty, kjo po i ndodhë fëmisë tond, osht' diçka e pafund a, siç thashë një tmerr i pafund.

Edhe ajo do të thotë, kur do të kthehemi ne në fakultet, në një vend dinjitoz edhe të bëjmë një... e tash normal janë ata që e vlerësojnë sa ka qenë, sa kemi punu, qysh kemi punu, e tjerë, çfarë efekti, cilësia, po e kemi bo më të mirën sigurisht. Edhe studentët e kishin vullnetin, vinin, e tash kur je i lirë... gjithmonë është ajo, është psikologjike kur e ke të ndalume diçka, kur e ki me njëqind rreziqe i përkushtohesh më shumë, e kur e ki në lerë e lëshon sepse osht' diçka që e ki aty që osht' pa, pa problem.

Anita Susuri: Deshta me ju pyt edhe për...

[Këtu ndërprehet intervista]

Anita Susuri: Mësimi nëpër shtëpia, këto deshta me pyt edhe pastaj me vazhdu. Për Pajtimin e Gjaqeve nuk e di jeni angazhu vetëm për qat' dokumentarë?

Nerimane Kamberi: Jo, jo, s'du... vetëm për dokumentarë, unë nuk kom marrë pjesë me studentë tjerë që, me Myrveten e këta, jo.

Korab Krasniqi: Me vazhdu për luftën...

Anita Susuri: Jo, se jonë këto demonstratat...

Korab Krasniqi: Po.

Anita Susuri: Forumi Gruas që i ka bo këto...

Nerimane Kamberi: Po, aty gjithmonë kam marrë pjesë, kështu si masë, po jo domethonë, në organizim jo.

Anita Susuri: Po s'do me thonë organizatorë, mirëpo me na tregu atmosferën qysh ka qenë, ndoshta pak me folë edhe për Prishtinën e viteve '90-ta, atmosfera e qytetit, presioni politik, mbijetesa, kultura? Krejt këto qysh janë ndërlidhë?

[Këtu ndërpritet intervista]

Nerimane Kamberi: Harrova me cekë te rasti i studentëve atë imazhin që ju thashë masën, po në anën tjetër Prishtina ishte e zbrazët. Edhe domethonë ishin dy pika të nxehta {hap dhe bashkon duart} ishte salla ku Kosova frymojke me sallën "25 Majin" studentët edhe minierat. Edhe në ato miniera ndodhke gjithçka politike, diplomatike, këtu ishin studentë edhe Kosova ishte e heshtun komplet. Atë ndjenjën si në luftë, s'levizte kurgjo, ajo më kujtohet shumë. Pastaj domethonë, pastaj kom marrë pjesë në shumë protesta, në lëvizje të grave, jo si organizatore. Kurrë nuk kam dashtë edhe vazhdoj të mos dua të jem në këshilla organizativë, në krye të këtyre po veç e kom, e kom ndjekë hapin me të tjerat.

Edhe te rasti, siç ju thashë i pajtimit të gjaqeve, me këtë dokumentarin po kurrë domethënë si organizatore, nuk e di vet ashtu është zgjedhja ime. Por, gjithmonë kam dashtë me qenë pjesë e tyre, me qenë aty, me përcjellë edhe përmes shkrimeve edhe përmes takimeve me të huaj. Unë i përkas gjeneratës së '90-tës që ta lidhim me atë që edhe kam qenë shumë në terren, po pastaj kam qenë vërtetë prishtinalike në thonjëza {bën thonjëzat me gishta} e huazume, e adoptume, qysh doni ta quani. Domethonë i kom përcjellë edhe në librin tim e kom një reportazh të kafeve të '90-tave edhe të pas '90-tave.

Domethonë, e kom bo ni reportazh të... një shkrim të gjatë, "Historia e Kosovës përmes kafeve", lokaleve. Ku e filloj me "Papillonin" i cili faktikisht ishte lokali jonë në '90-tat edhe plus normal Kurrizi, e di që është bo edhe një dokumentar rreth Kurrizit. "Hani i Dy Robertëve", "Papilloni" pastaj këto ishin lokalet ku ne shkonim, takoheshim me të huaj, i sjellnim ata, e ribënim botën, historinë, merrnim vendime. Unë kom qenë aty ndër tjera, kom organizu, në parlamentin rinor që kemi kriju, domethonë si, si një parti, mos ta quaj parti po lëvizje, ndër lëvizjet e para në atë kohë që dilnin nga partia. Domethënë, që që u dallonin, diferenconin nga Partia Komuniste apo Partia Socialiste të asaj kohe.

Edhe Prishtina, interesant kur kam ardhë më jetu kom thonë kurrë s'do ta du këtë vend, se ashtu e kisha idenë. Pastaj sigurisht që t'i dashurohesh me ni vend që jeton edhe sidomos kur përjeton kaq

shumë gjëra qoftë të mira apo të këqija. Edhe unë prapë isha në grupin e gazetarëve, intelektualëve të ri, takoheshim nëpër shpija. Normal i përjetuam bashkë orët policore, arrestimet e shokëve, vrasjet e shokëve. Edhe ishin domethonë vite shumë të randa, vite shumë dinamike, për neve edhe shumë euforike se bënim gjëra. Kishim ndjenjën që vërtetë po kontribuojmë për Kosovë dhe secili kontribonte në mënyrën e vet.

Anita Susuri: Te vitet e '90-ta deshta pak me u ndalë tek demonstratat që i përmendët edhe kanë qenë marshet, marshi me bukë në dorë...

Nerimane Kamberi: Po, marshi me bukë.

Anita Susuri: A ju kujtohet ajo ditë, si ka ecë?

Nerimane Kamberi: Marshi me bukë më kujtohet... më falni nganjëherë mu edhe më mashtrojnë imazhet e fotografive të Hazirit [Reka] se ka fotografi me bukë kështu {ngritë dorën} edhe sigurisht që dikun bohet në kurshllus [ndërlidhje] i kujtimeve të mia dhe fotografive të tij. Sigurisht, dhe gjithmonë e kom këtë imazhin e grave edhe osht' mirë që po punohet vazhdimisht edhe me këto protesta e tyne, me, me, me, me kontributin e tyre, sepse ishin vërtetë shumë të vendosuna edhe pa frigë në asnjë moment.

Mos të harrojmë që kishmi gjithmonë përballë policë, ushtri të armatosur edhe mos të harrojmë domethënë që e kishim mrapa në histori të Kosovës. Sidomos pastaj kur ndodhën, kur ndodhën Kroacia dhe Bosnia çdo gjë ishte e pritshme. Por këto, këto gratë domethonë ishin vërtetë, ishin të pa frigshme, ishin të vendosuna edhe... prapë këtë nisjen e tyre, gjithmonë ato lidere të themi, ato prijëset a, ta përdori një fjalë pak ma të fortë. Prijëset edhe masa, gjithmonë momentin që thirrnin gjithmonë mrapa i kishe të tjerët.

Anita Susuri: Ju kujtohet ndoshta që keni shku deri në një pikë edhe jeni ndalu prej policisë?

Nerimane Kamberi: Po, po. Po më kujtohet që bisedonin, domethonë prijësit mundoheshin me negociju me policë gjithmonë. Po atëherë dhunë nuk osht' përdorë, nuk osht' përdorë fatmirësisht.

Anita Susuri: I përmendët këto aktivitetet kulturore që kanë ndodhë, për shembull te "Hani i Dy Roberteve", "Papilloni" e te Kurrizi, a mundeni me na tregu diçka për shembull ma konkretisht? Ka pasë ekspozita po më duket?

Nerimane Kamberi: Po, po, po edhe në, edhe në që thashë në reportazhin tim, po edhe para disa jave isha në promovimin e librit që e bonën pronarët e "Hani i Dy Robertëve" që është vërtetë një kujtesë e jonë, për ne domethonë që silleshim në këto qarqet gazetareske, të artistëve. Ishim një grup që njiheshim, përkthys. Unë në atë kohë kam punu edhe për Qendrën Informative të Kosovës.

Domethonë te Lidhja Demokratike, ku u formu Lidhja Demokratike e Kosovës edhe kom qenë aty domethonë si përkthyes e lajmeve në frëngjisht. Kështu që, ne ishim një grup që njiheshim. Edhe normal që në filltet e Lidhjes Demokratike të Kosovës kom qenë edhe unë aty. Edhe ishim përafërsisht gjithmonë gati të njejtat figura, të njejtat njerëz, ne pak ma të ri, intelektualët e asaj kohës, artistët, Agim Çavdarbasha, ishte Nekra që bënte karikaturë.

Domethonë ishim një grup, një grup artistësh, përkthysësh, gazetarësh edhe “Hani i Dy Robertëve” edhe “Papilloni” ishin vende... Po “Hani” sidomos mbetet si një vend i lëvizjeve diplomatike, gazetareske, ni copë Ballkani me një shikim kah Perëndimi, me një thirrje ni SOS kah Perëndimi. Edhe këto ishin vende, atëherë ishin vende ma të pakta sigurisht, ishte edhe rrezik se çdo moment mund të hynte policia, mund të arrestonin, mund të rrihnin dikend. Rasti për shembull kur u vra edhe aktorja Adriana [Abdullahu], ku ne ishim të ftuar të merrnim pjesë në hapjen e... domethonë te Santea se na edhe jetojmë në Sante aty. Edhe nuk kemi shku atë natë, fatmirësisht, e kemi pasë ftesën edhe ka ndodhë vrasja. Domethonë, ishte...

Anita Susuri: Cili vit ka qenë?

Nerimane Kamberi: *Mon Dieu* [fr.: Zoti im]...

Anita Susuri: Pak para luftës?

Nerimane Kamberi: Pak para luftës ka qenë ajo. Nejse tash u projektova më vonë, por po du me thonë këto vitet e ‘90-ta, sidomos ‘97, ‘98-tën kur kemi fillu edhe në terren me punu ishte gjithmonë një kontrast, sepse ti ishte në Drenicë, në Rahovec, në Suharekë ku veç kishte konflikte, ku ishte UÇK-ja, ku luftonin njerëzit, ku kishte njerëz të zhvendosur, në malet e Berishës, në Pagarushë e tjerë. Tash kur vishe në Prishtinë ishte ni realitet krejt tjetër nga ajo që shihej. Ishte një normalitet jo normal, nëse mund ta quaj kështu. Ishim tërë kohën në terren tu e pa tmerrin, tu e pa luftën faktikisht edhe Prishtina mundahej të jetonte një jetë pak sa normale.

Anita Susuri: Ju thatë që ju ka rasisë shumë herë si gazetare me has në vende ma rurale, çka ka qenë diçka që ndoshta ju ka lënë një përshtypje ma negative apo pozitive?

Nerimane Kamberi: Po, domethonë, prej asaj kohe që ju shpjegova me epizodin e... domethonë te pajtimi i gjaqeve më boni me kuptu për shumë gjona për të cilat ndoshta nuk kishim mendu. Mbaj mend që me një familje më duket në Komunën e Suharekës, gratë m’u lutshin, m’u lutshin mu se unë folsha shqip, isha ajo me të cilën ma lehtë komunikojshin. Thojshin, “O bëni çmos që të pajtohen, që të falet ky gjak”. Sepse këto domethonë ishin bo shtyllat, pa dashje shtyllat e familjes, kur çdo gjë kishte funksionu atëherë përmes burrave.

Domethonë këto gra ishin kryesisht të pashkolluara, tash kishin mbetë me kry çdo punë që sot për ne është normale, deri diku. Atëhere prej ma të thjeshtës me i grrah traktorit, sepse tokat kishin metë. Burrat ose ishin mbyllun, ose ishin... domethonë mbyllun në shpi ose të mbyllun në burg. Edhe këto tash kishin punët e tokës, punët administrative, sado që të ketë, pazarin. Domethonë, ishin gra që përneherë ishin vnu në krye të shpisë, në udhëheqje të shpisë. Ku në ato shpija ato s'kanë pasë... e kanë pasë atë rolin që me bo fëmijë, me rritë fëmijë, me bo bukë, por jo me pasë detyra tjera. Edhe mbaj mend vërtetë ato e kishin si thirrje, si lutje, "Të lutëm bëj ç'mos që të pajtohen vërtetë". Edhe domethonë ndoshta historia i ka lonë shumë në hije këto gra prej fillimit.

Ndesh në luftë rolin që e ka pasë, mos të flasim pastaj çka kanë pësu, po edhe rolin që e kanë pasë. Burrat ose kanë hi në UÇK, që kanë luftu ose që janë fshehur edhe gratë faktikisht janë lonë të vetme edhe jonë lonë të vetme me i bajtë, me i bajtë... Pleqtë me i rujt, me i rujtë fëmijët, shpinë edhe gjithmonë rreziku. Domethonë, prej asaj kohe të pajtimit të gjaqeve. Normal edhe prej ma heret në terren, sepse normal kemi qenë shumë të paarsimume si femra. Kemi pasë shumë pak rol udhëheqës në shpi ma së pari, ku kanë qenë rolet e ndame, sociologët këto e shpjegojnë shumë mirë. Por shumë mirë i kom përjetu edhe vet, domethonë.

Po sigurisht që këto situatat ekstreme, situata siç thashë pajtimi i gjaqeve. Pastaj edhe shumë e kuptushme që në lëvizje pastaj edhe të pajtimit ka pasë vajza se mos të harrojmë në anën tjetër ka pasë femra të burgosuna politike, të cilat kanë qenë në krye të '81-shës, në krye pastaj edhe të pajtimit të gjaqeve. Edhe shumë normale që pastaj ato kanë dalë, po me ni anë kanë dalë se prej fillimit kanë qenë guximtare, kanë qenë prijëse, po në anën tjetër sepse vërtetë imazhi i tyne u pranu ma lehtë sepse këto kanë qenë të burgosura. Domethonë, këto kanë pasë një emër të cilin ta ka pranu shoqëria shumë ma lehtë.

Edhe domethonë te ky pajtimi kur e pata pa, sepse thashë unë Kosovën e kom njoftë shumë pak. Unë kom qenë preshevarë, kom ardhë kryesisht në rrethe familjare. Nuk e kom njoftë këtë anën e pjesës rurale, pjesës odave me shumë respekt normal për të gjithë ato po prapë kjo puna në terren edhe takimi me njerëz më ka bo me i kuptu shumë ma mirë këto. Edhe te pajtimi gjaqeve, domethonë ajo ana kur gruaja u dashtë me falë ka qenë shumë ma e madhe se deri atëherë nuk u pyt ajo a po pajtohen a s'pajtohen, a faktikisht ju ka vra djali. Tash ai dimenzioni mos të harrojmë nanë-fëmijë edhe ajo... Për shembull, në rastin ku kemi bo dokumentarin, asaj ju kish vra fëmija, po ajo ishte anëtar si çdo anëtar i familjes edhe sigurisht që atë nuk e pyte burri vet a ta fali, a s'ta fali? Mendimin e vet, sepse ishte e ndërtume asisoji.

Edhe sigurisht pastaj të '90-tat të gjitha protestat që i bomë në rrugë tash gruaja jo studente, sepse prapë çdo herë statuti ta jepte ni vlerë ndryshe. Edhe tash gruaja cilado qoftë, gruaja intelektuale, gruaja profesoreshë e UP-së, domethonë ato prijëset, po pastaj të gjitha ato të tjerat, gratë e fshatit, gratë e paarsimume, të arsimume u bonë të njejtat rreth një kauze, rreth një ideali. Edhe kjo osht' mirë

që tash në këto vitet e fundit çdo herë e më shumë po vihet në pah sepse osht' harru, osht' harru roli i saj, osht' harru pozita e saj.

Siç ju thashë edhe në luftë, unë kam taku një vajzë që është dhunu në luftë edhe ndjenjën e braktisjes, "Na lanë". Domethonë, në atë kuptimin na lanë në durtyrë e sërbeve, në duart e sërbeve. Domethënë, i kanë lonë baballartë, i kanë lonë burrat e tyre, i kanë lonë vllaznit. Ata të cilët deri në atë kohë ishin ata që i mbronin, ja mbronin nderin, ja mbronin emrin edhe përneherë ata u zhdukën. Edhe kjo vajza domethonë kish përfunduar skllave seksuale pa kurrfarë mbrojtje edhe tash kjo osht' sigurisht një debat tjetër, për ato sigurisht që osht' folë më pak, një ndër këto arsye.

Pastaj, tjetra, ni dokumentar që e kemi bo te familja Bogujevci të deputetes Saranda, ai ka qenë ndër ma të randit për mu se e kemi bo menherë '99-tën. Edhe aty gjithë familja, se u konë ideja që në qytet nuk ndodhë kurgjo, gratë s'i prekin, si ide e Luftës së Dytë Botërore. Edhe ka me qenë luftë burrë me burrë edhe këto ishin metë gra edhe pleq edhe ndodhi ma e keqja. Domethonë, ka pasë ide të gabume që vetëm burrat do të bijnë viktimë edhe fatkeqësisht e kemi pasë shembullin e Bosnjës që ka qenë ma i freskëti, që u ditë, po unë nuk po e ribëj historinë, ka njerëz më të aftë për këtë punë.

Femra domethonë në çdo moment, në çdo moment e ka pasë të vështirë. Kanë pasë burra po në kuptimin që sigurisht piramida familjare osht' rrënu një moment, nuk ka qenë mo plaku, burri, ai që udhëheqë, e kom pa domethonë prej pajtimit gjaqeve, pastaj sigurisht edhe deri te lufta. Jom mundu edhe në reportazhet e mija, edhe pse gjithmonë jo në fokus vetëm ato i kom pasë, po që ta tregoj këtë rol edhe... sepse na ka gjetë '99-tën në një gjendje tash të ribëj edhe Zoti mos e bëftë që të na ndodhë një luftë prapë, jemi në një situatë tjetër, në një mentalitet tjetër.

Në atë kohë na ka gjetë të varfër, na ka gjetë të paarsimuar, na ka gjetë në role të shumë grave të cilat nuk i kanë pasë deri më atëherë. Deri ndoshta që edhe prej katunit s'janë dalë vet, e përneherë ju është dashtë me u end nëpër Kosovë e prej një skute në tjetër, e me fëmijë, e me rrezik e tjera. Luftë mo, s'ka qysh e spjegon ndryshe.

Anita Susuri: Ju thatë që në kohën e luftës jeni largu, por po du me ditë qysh ka ndodhë qajo edhe në cilin moment keni vendos, si keni vendos?

Nerimane Kamberi: Ju thashë që ne burrë e gru kemi punu shumë në terren, kemi rreziku shumë shpesh, minat, kemi arrestimet, marrjes së pytyes edhe e kemi pa normal tmerrin nëpër Kosovë. Kështu që, unë isha humanitare edhe '98-tën punoja për Mjekët e Botës ku kom qenë përgjegjëse për të drejtat e njeriut, Human rights officer. Edhe kështu që... edhe ja u spjegoj studentëve të mi sepse është një vepër teatrale franceze që e merr temën antike po flet për Luftën e Dytë në Francë edhe tërë dialogu zhvillohet që a do të ndodhë lufta, a mos të ndodhe, vendimet të cilat do të merren. Edhe na aty përcjellnim, domethonë çka po bohet në Rambuje. Edhe sigurisht që kërkush nuk e donte luftën edhe ndodhi.

Domethonë u vendos që do të fillon, do të fillojnë bombardimet edhe ne aty te Mjekët e Botës na thanë që, “Kush don mund të vijë me neve”. Sepse ju dha urdhër organizatave që të largohen nga Kosova edhe kështu që unë i thashë motrës, e cila ishte e pamartume. I thashë, “Ti je e vetme e merr vendimin për ty, ti ik”. Edhe unë ni ditë përpara e mora djalin i cili kishte katër vjet, e largova e çova të prindërit në Preshevë. Thashë atje do të kalon ma mirë edhe sërëbët ma shkynë letërnjoftimin. Kështu që, une s’mujsha këndeje m’u kthy. Shumë fshtirë se në luftë vendime ish shumë fshtirë me marrë. Gjithmonë në jetë është vështirë me marrë vendime të mëdha, po në ato rrethana ish shumë fshtirë. Po vendimi që unë tash gjithsesi po kthena në Kosovë.

Haziri, burri, punonte për agjensinë Reuters, fotograf edhe e njihnin normal prej terrenit edhe ai prej fillimit ishte i mendimit të largoheshim. Une... dhe mendoj që ka qenë një vendim shumë i gabuar i imi që mos të largohemi. Kisha idenë, ndihesha si tradhtare. Prapë ajo ide që e bartsha prej rinisë që duhet të jem aty. Edhe mendum pra do të rrimë. Fëminë, djalin e patëm të sigurtë. Edhe mblidheshim me miq, shumë interesant ka qenë se ka momente nganjherë komike në gjithë këtë tragjedi. U mledhshim me këta fqinjë e tanë edhe më thirri një gazetar prej Francës tha, “Neriman” tha... telefonat bonin atëherë, dhe tha, “po e shohim që po nisen prej Avianos aeroplanat e NATO-s, qysh osht’ atmosfera në Prishtinë”. Edhe unë ja përshkruaj edhe në atë moment fillun sirenat.

Edhe ish ni përjetim nga filmat, unë veç në filma kisha ndëgju sirena të luftës. Edhe kur i thashë se... i dëgjoj edhe ai sirenat edhe e mbylli telefonin (buzëqeshë). Ishte shumë ajo ndjenja e tmerrshme. Edhe mblidheshim domethonë te fqinjë edhe ata i kishin largu gratë me fëmijë, e unë isha vetëm me zojën e shpisë, domethonë nanën e atyre dy vëllezërve. Edhe nuk kisha frikë, du me thonë që ‘98-tën shumë kom pasë frigë. Kur jonë vra Jasharajt, une kom ra në një gjendje psikike që kaq frigë kisha as fëminë nuk e çojsha në qerdhe, flejsha me dritë dhezë. Ishte ni frigë që nuk mujsha me kontrollu, nuk mujsha me mposhtë, kisha frigë me hy edhe në lokale.

Edhe e pata një ftesë me e përfaqësu Kosovën në një konferencë në Paris, në qershor edhe kur shkova atje, e pashë sa e bukur është jeta, sa e bukur jam unë, e kisha një fustan me lule... edhe u shërova. U ktheva në Kosovë. Kështu që, mo nuk kom pasë frigë asnjherë; që nga një anë është budallallëk se duhet me pasë frigë në luftë. Po e mbaj në mend motra jetonte në Arbëri, në Dragodan edhe telefoni bënte, thashë, “Po vi me të pa”. Edhe më tha, “Ti ose je çmend, ose je tu marrë drogë” tha, “jemi në gjendje lufte”. Edhe ndoshta unë edhe e refuzoja kështu në ndërvedije.

Po vërtetë në Sante ishin tenkat e sërëbëve, edhe unë në hyrje i kisha... se ishin këto hyrjet tri katëshe, kisha kojshi sërëbë. Edhe kur e bombardun tash që është kazerma “Adem Jashari”, domethonë shumë afër, po unë kam qenë fjetë. Edhe më ka thirrë ni gazetar edhe e ka marrë burri. Thotë, “Po të thërret një gazetar”. Edhe thotë, “Neriman” tha, “osht’ bombardu kazerma kryesore e Prishtinës” edhe kur i kom thonë, “Më fal unë kom qenë fjetë”. Ai s’mujke me marrë me mend edhe as unë s’muj me marrë

me mend tash, se shumë afër e kisha. Por, ndoshta ajo frika e madhe nënvedije tash edhe s'e kisha ndi. Tha, "Po bombardohet qyteti jot, ti po flen" (qeshë).

Ai s'mujke me mendu, as unë tash s'muj me mendu, po ishte domethonë e tillë. Edhe veç filloi, në dëlëm në Kurriz me ble diçka çka kish mbetë me ble. Deshtëm me ble bukë edhe na tha në furrë, tha, "Largohuni, shkoni në shpi" tha, "se e vajtën ni sërë qetash, veç kanë fillu" tha, "problemet". U kthym, e për dritare i shihsha kojshit e mi sërë, ja mshojshin shiptarëve, kush kish qese me... që kish ble diçka, ja shutojshin. Edhe filloi çdo moment me u bo rrezik. Fatmirësisht, bënte radioja, ndëgjum që ish marrë Bajram Kelmendi me djemtë.

Une i nijsha se unë kom qenë, tash te rrëfimet po kthehem, unë kom qenë anëtare e Këshillit të Drejtave të Njeriut, '91-shën kam qenë në Amerikë me bacin Adem Demaçi, me një delegacion për me tregu çka na ndodhte në Kosovë. U patëm taku me Bob Dollin. Ishim në Amnesty International në New York Times, e bonëm një udhëtim për t'i vetëdijësuar ata, për t'i informuar se çka ndodhte. Haziri ishte pjesë e delegacionit me fotografi të vramëve, të arrestumëve. Edhe e përcillte bacën Adem, i cili sapo kishte dalë prej burgut. Edhe ajo ka qenë në peripetësi se shkumë në Vjenë nuk ja dhanë vizën bacit Adem, tani në Londër ja dhanë. Normal kemi qenë tërë kohën me të me rrëfimet e tij.

Edhe unë edhe në kuadër të Këshillit të Drejtave të Njeriut, domethonë kom bashkpunu rreth të drejtave të njeriut. Edhe kështu që, edhe në kuadër të punës humanitare që e bëja me Mjekët e Botës, unë bëja raporte se çka kishte ndodhur në terren në pjesët të cilat i vëzhgonim, i përcillnim. Edhe kështu që na ato ditë veç fillum domethonë me ditë që ka ardhë koha me ikë. Në shpi te ajo banesa ku fshiheshim vnojshim, kanë qenë atëherë ato termot {hapë duart} me qindra kille, ormanet mos me na i thy. E pastaj e kemi kuptu mas lufte që sërëbët i kishmi pasë në tavan se i kemi gjetë armët, e thasët e... se e kanë vëzhgu Dardaninë aty tërë kohën në rrugën tonë te Santea.

[Këtu ndërprehet intervista]

Domethonë, filloi çdo moment me qenë rrezik edhe javën e kalume e kom publiku... se për 20 vjetorin e luftës së Kosovës i kom bo tri reportazhe për gazetën "Le Courier des Balkans", për portalin. Edhe një ndër ta është koha jonë si refugjatë në Maqedoni. Edhe vendosëm me kojshitë, se kerri jonë s'na bonte që të largoheshim, mendonim me shku andej nga Graçanica për Gilan. Na nalën paramilitarët, nuk na lanë, u kthymë edhe aty ka qenë, "A po kthehemi në banesë apo nisemi për Shkup?" Edhe vendosëm për Shkup edhe aty na ndalën paramilitarë, ja u kemi dhonë 500 marka edhe kemi daë në Maqedoni. Fatmirësisht, ka qenë para tmerrit të Bllacës momenti kur ne mundeshim me u largu.

Edhe dolëm na pritën kolegët e burrit nga Reuters, të cilëve ju kishte ardhë shumë keq. Normal që në një mënyrë na kishin lonë në Prishtinë. Edhe ajo ka qenë një moment tjetër komik edhe i dhimbshëm osht' që ata na morrën na çunë në hotel edhe në hotel s'kishte mo dhoma. Në Hotel Kontinental, se ishin krejt gazetarët, e krejt delegacionet e huja këtu, i vetmi vend ishte suita. Domethonë, ne e kishmi

nji suitë, po s'e kishim mo shpinë (qanë). Edhe... kështu që u përqaftim, fillim me kajtë që ishim gjallë edhe e fillim jetën e refugjatit në Maqedoni.

Unë po ju them kam mund me shku në Belgjikë, se isha belge, po doja të jem afër, afër Kosovës edhe ta vazhdoja atë kontributin e vogël që mujsa me pasë. Edhe kemi qëndru, domethonë, fatmirësisht ne nuk jetonim në kamp se e arritëm kohën e duhur, morrëm një shpi me qira. Edhe ish shumë interesant se punojsha te Mjekët e Botës, domethonë unë isha në Bllacë kryesisht punoja në Bllacë edhe pastaj punoja në zonë neutrale *no man's land* [ang.: toka e askujt].

Aty ku kishim të drejtë ne si organizatë me shku {zgjat duart} m'i pritë njerëzit që ishin të lëndum, që ishin ma randë. Edhe aty e kom pritë domethonë familjen e Fehmi Aganit, i kom marrë dëshmitë e tyre, rasti parë, personi parë me të cilin jom taku. Pastaj kemi pasë robët e luftës të parët që kanë qenë, që janë liru, 36 burra që i kanë pru me autobus deri në kufi. Mjeku jonë i ka kontrollu, kanë qenë në gjendje shumë të keqe me tortura e tjerë. Unë i kom marrë dëshmitë i kom shënu. Normal raport i bojsha gjithmonë Parisit, për ato që bonin.

Anita Susuri: A kanë qenë serbët ata robë?

Nerimane Kamberi: Ata jo, ata kanë qenë robë të luftës, i kanë zonë nëpër kolona, kudo që kanë qenë, secili e kishte një rrëfim. Pastaj i kanë rrahë, i kanë fut në burg edhe për çudi i kanë liru. Edhe ajo që ish interesant erdhën te Mjekët e Botës mjekë përforcim e s'kishte mo vend në shpinë që ata e merrnin me qira. Edhe unë propozova me e lëshu ni dhomë në shpinë ku ishmi na me qira, e ja lëshova me qira atyne (qeshë). Thashë edhe në luftë po u gjindshe gjithqysh. Ata nuk e dinin që unë isha refugjate edhe më thanë, "Po pak si shtrejtë qiraja", po thashë, "Ku e di une sa zgjat kjo luftë, mu më vyn pare". E pastaj i erdh keq shumë, thashë, "Unë jom refugjate" thashë, "ndoshta lufta zgjat shumë e më vyn pare". Ishte ajo ana komike, po thashë qe sa e gjindshme, diçka me bo.

Kështu që, domethonë kemi qëndru tre mujë, kemi bo raporte, Haziri ka bo fotografi. Aty e kanë pasë gjetë ni plakë familjarët e saj, e kom tregu edhe në reportazh... (përlozet) Fëmijët e saj e kanë... ata jetojshin diku në Skandinavi, Suedi a Norvegji, e kanë gjetë nonën e tyne përmes fotografisë së Hazirit edhe e kanë gjetë në agjensinë Reuters, e kanë gjetë fotografën, na kanë thirrë në shpi. Edhe të nesërmen na dulëm nëpër kamp me lyp me fotografi, po ato e paskan çu në Turqi, që i bojshin ato që i dërgojshin me transfer humanitar. Edhe fillimisht s'ka pasë në kampin e... në kamp s'ka pasë as në Stankovec, mo Bllacë mos të flasim, për Bllacën, po në Stankovec nuk ka pasë telefona, nuk ka pasë.

Kështu që, une tash, kishte njerëz që më ndalshin, se e kisha jelekun e humanitarës, ma jepnin ni numër, thojshin, "Thirrë këtë njeri, këtë çikë, këtë djalë, thuj që jom gjallë, që jom mirë, që jom këtu". Edhe kur shkojsha tani në shpi atje te Mjekët e Botës, në zyre, telefonin edhe i thirrsha krejt botën. Edhe thojshin tash... a dinë kisha reagime të ndryshme, dikush bërtitke, dikush të urojke, dikush kajke, atë zë në telefon, ishte shumë e fshtirë. Pastaj kushtet u përmirësun pak për ta, unë kryesisht në

Bllacë punojsha edhe në Stankovec. Interesant se edhe portali kur ma ka kërku parvjet me bo, shumë fshtirë e kom pasë me pranë këtë rrëfim, pastaj e bëra. Fshtirë e pata me rilexu, fshtirë e pata me dërgu, po mirë që e bëra se normal po mbetet diçka nga ajo kohë.

Megjithëse, shumë e fshtirë (përlozet), domethonë kur e mendoj ku kom qenë e prej nga kam ardhë e çka kom përjetu personalisht. Osht' shumë interesant se te Mjekët e Botës e kishim një bashkëpunim, ni partneritet me Federatën Ndërkombëtare të Drejtave të Njeriut në Paris edhe erdh ni zojë, avokate ishte, ajo u merrte me refugjatë në Shqipëri. Edhe tha, "E pyta ni refugjat çka doni me tregu?" Po, tha, "Mu s'më ka ndodhë kurgjo". Po thotë, "Zotëri qysh ke ardhë këtu?" "Po" tha, "më kanë qit prej shpisë", "po a s'osht kjo". Ajo ideja që e kemi se duhet me ndodhë ma e tmerrshmja, po mjaftonte që ti e ke braktisë shpinë se osht' e drejtë elementare e jotja.

Këtu e boj atë, e përmbylli atë rrethin tem që unë isha rritë me ato idetë iluministe, deklaratat e të drejtave të njeriut që kemi drejtë për arsim, për shpi, një jetë të dinjitetshme. Edhe kisha përfund që t'i shoh përkundrazi, ishte diçka që nuk ish realitet edhe që ajo bohet diçka për mu nuk e kisha mendu sigurisht kurrë. Domethonë, pak si, si, si një thënjë, kurrë mos mendo që nuk mundet me të ndodhë ty, qoftë edhe ma e tmerrshmja, lufta. Sepse vërtetë kur vija une prej Belgjikës këtu, lufta ndodhte diku larg ose diku larg në kohë, ishte Lufta e Dytë që e kishin përjetu, domethonë gjyshët e stërgjyshët, prindërit e mi kishin qenë të vegjël ose në kohë ose në hapësirë.

Domethonë, lufta ndodhte në Afrikë, në Azi, po lufta në Evropë që unë do ta përjetoja vet edhe domethonë prej kthimit tim, të gjitha këto fatmirësisht përfundoi mirë se nuk pata humbje në familje, e rigjeta djalin tim po këtë nuk du me... (përlozet).

Pjesa e Katërt

Anita Susuri: Si e keni marrë lajmin që u shliku, hinën forcat e NATO-s në Kosovë? Ku keni qenë dhe si e keni pritë këtë lajm?

Narimane Kamberi: Kom qenë në Shkup, normal i përcjellnim vazhdimisht lajmet. Ni detal që unë nuk osht', nuk osht', unë nuk e kom dëgju po djali im... se na erdhi vjehri prej Gjermanisë, ndjesë pastë, edhe ai e kqyrke djaln edhe priste vazhdimisht lajm, kush erdh prej Ferizajit, a dul. Edhe në reportazh e kom thonë, edhe si vinte dikush që dilte prej Ferizajit i blejke xhygyma të çajit (buzëqeshë), çaj edhe vinte deri te dera e kampit, m'thirrke me ja u pru atyne, me marrë lajm.

Edhe ai e kqyrke djaln, edhe ish shumë interesant se djali miqësohej me një djalë tjetër refugjat andej rrugës, ai i Kaçanikut. Edhe djali filloi me folë me theks të Kaçanikut (buzëqeshë). Ai i bani katër vjet në luftë, ia festumë atje, se n'maj. Edhe tha, vjehri tregoi, edhe... që atë natë që u nënshkru, që do të nënshkruhej, ky [djali] qysh ka qenë tu luftë, lufta, e ka gjujtë, ni shtagë po m'dokët, ka thanë, "Gjysh, u

kry lufta”. Edhe... babë i ka thonë, “Babë, u kry lufta”. Edhe ai e mendonte si diçka, parandjenjë. Po, sigurisht që na i përcjellnim ato.

Unë, qysh e prita, po sigurisht që ishte një lajm shumë i madh, po edhe kisha shumë frikë se çka do të gjenim. Se une tre mujë punova në kampe. Edhe motra ime punonte në kampet Kukësit...

[Këtu ndërprehet intervista]

Motra ime punonte, domethonë ajo që ju thashë që u largu prej Kosove për Shkup, edhe si filloi kriza e madhe në Kukës, i kanë propozu që të bartën në Kukës. Edhe ajo... na dhanë pushim të dyave, edhe ajo u bartë prej Kukësit me helikopter për Tiranë, se kushtet kanë qenë t’udhëtimit shumë vështirë, edhe unë shkova në Shqipëri. Ishte hera e parë që shkoja në Shqipëri edhe kurrë s’kisha dashtë që takimi i parë për atë Shqipëri të cilën sigurisht kemi pasë t’gjithë qef ta shohim, që të ndodhë në asi rrethana.

Edhe... po motrat u takuam domethonë në Tiranë. Po ajo nuk fliste, kurrë nuk ka... qato dy ditë m’dokët sa kom nejt edhe e maj n’mend atë shpi ku ishin me qera, ishte oborri që ma kujtojke oborrin në shpi në Preshevë. Bike një shi ashtu si në Preshevë. Edhe... po ajo ton kohën (i mbushën sytë me lotë), masandej e kom marrë vesh që ishte me qetësues për ata çka kishte pa atje. Edhe ajo ndër të tjera, domethonë, ka taku familjën e mbijetume të Berishës të Suharekës, Shyretën {fshin hundën} edhe...

Kështu që, domethonë nga ajo që ajo m’tha, tmerr ka qenë, po kurrë, edhe sot nuk flet për atje çka ka ndodhë, çka ka pa. Edhe unë çka kisha pa tre muajt këtu, rrëfimet, dëshmitë, t’i shohësh miqët tu, kojshitë tu mrapa telave... mbaj n’mend një gru, erdh me një fmijë, ia kish mëshu hundëve, gjak, thashë, “Çka u bo?” Tha, “Ia mshova se po lypë bukë”. “Po”, thashë, “Ti nuk je mo nëpër mal. Ki bukë sa t’dush”. E morra, ishte ajo organizata që jepte bukë, e çova.

Kështu që, domethonë lirinë nuk e përjetova n’atë moment me një gëzim shumë t’madh. E para na e kishim lonë shpinë, kështu që nuk e disha a e gjejmë, qysh e gjejmë. Unë menihere kalova n’atë negativën, edhe pse nuk është nga natyra ime, po sigurisht ishin momente të tilla se çka do të gjenim, se çka... sigurisht edhe Bosnja ishte një përvojë, puna ime... përvojë, domethonë çka kisha ndëgjju se s’kom qenë atje. Çka kisha pa, përvoja ime, jeta ime, siç ju thashë prej të ‘80-tave, vet domethonë në Këshill të Drejtave të Njeriut, u helmova edhe une, protestat e këto.

Edhe... ishte një, një domethonë diçka e kryme, asaj që thojsha... po ende jo, se kisha ide që u kry ai tmerri i pafund, për të cilin ju fola që e kisha ndjenjën që kurrë s’do të merr fund. Edhe... po nuk isha shumë {pauzon} euforike që, “Ha, tash erdhi liria”. Aspak. Edhe Haziri erdhi menihere, burri, me ekipin e Reuters. Unë erdha m’doket mas dy-tre ditëve. Kështu.

Anita Susuri: Si jeni kthyer pastaj në normalitet? A ka qenë vështirë?

Narimane Kamberi: Po në normalitet jom kthyer sepse domethonë ka pasë shumëçka për të bërë, ka pasë... ajo që m'ka mbetë normal ka qenë përshëndetja gjithmonë që bojshim, "A jeni krejt?" Kur u takojshim n'rrugë, ajo osht' domethonë kujtesa e parë që e kam prej kthimit, "A jeni krejt?" Edhe... po pastaj shumë, shumë kishim punë, shumë kishim punë, vinin gazetarët, une tash duhej ta mbaroj magistraturën. Ish shumë një dinamizëm i madh, ishte kthimi, shumë njerëz që kishin mendu që Kosova do t'jetë mirë menjëherë, edhe ishin kthyer. Ndërtimi, puna në terren, bilanci.

Në '98-tën, domethonë reportazhet e para në qershor... se ma kujtoi një këngë të Leonard Cohen që thotë, "Qysh mendon që munden mu dokë ata?" Se shkova në burgun e Mitrovicës ku ishin të arrestum të dyshuar për krime të luftës, dy serbë e tre romë. Edhe isha me një avokat francez e na shkonim t'i takojmë e t'bojmë raport. Edhe si hyna thashë, "A je i sigurt që duhna me i folë atyne? Tha, "Po". "Edhe me ia zgatë", thashë, "dorën a?" Tha, "Po".

Edhe... ato domethonë... normal etika osht', etika, osht' çështja e mirësjelljes, po e kisha ndjenjën, a muj une me u sjellë mirë me monstruma? Me njerëz që m'kishin detyru me ikë, me lanë shpinë, me lanë fëmijë. Edhe... po normal, pastaj e kryjta punën si duhej. Edhe na tha një... qito vërtetë jonë kujtimet e para. Na tha një gjeneral, a ni francez, na tha, "Kthehuni tash nga Drenica edhe keni me ndi erën e vdekjes". Ishte vera e nxehtë se edhe pranëvera ke në Maqedoni shumë e nxehtë. Edhe u kthym nga ajo rrugë, sigurisht domethonë varrezat masive, era vdekje vinte gjithkund në Kosovë.

Kështu që, nuk kisha kurrfarë ndjenjë të lumturisë, edhe plus kur shkova në banesë e kërkova që KFOR-i t'hyn me neve se kishim frikë që kishte kurtha, domethonë *booby traps*. Unë e dija prej terrenit që kishte njerëz që ishin gjymtu prej këtyre kurthave. Ata s'kishin kohë me u marrë me neve, plus na ishim në një lagje, domethonë në Dardani, mikse, ku kish serbë ende. Edhe e mbaj n'mend ka ballkoni tenkat që i runin serbët e fundit që ishin aty. Edhe unë domethonë çdo sen që hapja merrsha frymë {merr frymë thellë} mos po m'kërsset ni *booby trap*.

Se morrën vesh nga një plakë, se edhe i gjetëm n'shpi, që kanë ndejtë te na serbët, dy serbë, të rij si duket, e i kishin lanë rrobat e tyre civile, si duket kanë ikë shpejtë e shpejtë. Edhe normal i kemi mledhë na senet që i kemi gjetë, pastaj edhe n'tavan, ia kemi dërgu... s'di kujt ia kemi dhanë, UNMIK-ut m'dokët. Po, hap çdo send, i gjetëm fotografitë e Hazirit t'gjitha, po ai e spjeron këtë ma mirë, t'gjitha të shpërndara. Edhe e kishin pasë veçu fotografinë e Fehmi Aganit, edhe ktu domethonë.

Po pastaj jeta e morri shpejtësinë e vet, dinamizmin, punë, punë. Shpija këtu në katund na osht' djegë në '98-tën, se katundi ku... nga vjen Haziri, Nerodimja, ka qenë katund me serbë, në '89-tën ajo osht' djegë. Në '98-tën, domethonë ikjet e para t'familjës tonë kanë qenë në '98-tën. Kanë qenë episode t'shumta se kanë ikë në Ferizaj, kanë jetu një pjesë në Ferizaj edhe një pjesë e familjës osht' mundu përmes lidhjeve me ikë në Gjermani. Edhe unë kom qenë n'atë verë me ni universitet veror për të

drejtat e njerit edhe kom ardhë e kom marrë djalin e kunatës, cili ka pasë moshën e djalit tim, po n'atë kohë në pashaporta s'kish fotografi, e kom qitë si djalin tem në Gjermani, e kom hypë në aeroplan.

Edhe na, ka qenë interesant se në '99 mas lufte kom udhëtu jashtë, prapë për një konferencë në Paris edhe në aeroport të Shkupit nuk m'linin me fluturu me djalin, thojshin, "I ka dokumentet, a din, jonë dokumente false". Thashë, "Ti zotëri, une e kom kalu fëmijun e hujë me këto dokumente". Shumë u trimnova (qeshë) tash po thom palidhje, po s'kish naj fakt, s'kish çka me m'bo. Thashë, "E kom kalu fëmijun e hujë, tash e kaloj temin pa problem se çdo gja osht' në rregull". Po du me thanë që ishim t'gatshëm me bo çdo gjë për me e ndihmu njoni-tjetrin për me mbijetu. Edhe shpija këtu osht' djegë komplet, e ka rindërtu vjehrrin im i ndjerë.

Edhe kom vazhdu punën, si në univeristet, si me gazetarë, si në... se që ju thashë kom studiu në juridik edhe këtu kom vazhdu juridikun. E ndoshta i vetmi moment pak euforik që e kom pasë osht' që, "Haha {onomatope}, do t'a mbaroj fakultetin". Se e pata lanë juridikun për pak provime. E regjistrova semestrin edhe kurrë nuk e mbarova. Po punova vazhdimisht në fushën juridike me Avokatë pa Kufij, me noteri, e tjera. Edhe e përcjella domethonë nga larg e nga afër Kosovën e pas luftës.

Anita Susuri: Deshta veç edhe të një pjesë me u ndalë, se mendoj që osht' shumë me rëndësi, te helmimet e studentëve, nëse mundeni ma na tregu përvojën e ju, përjetimin?

Narimane Kamberi: Po, unë domethonë atëhere nuk isha unë nxanëse se siç e dini kryesisht ka ndodhë nëpër shkolla, nëpër... unë kom qenë tu shku në "Rilindje", domethonë te shokët e mi te "Zëri". Edhe para derës të "Rilindjës" jom aliva... domethonë, kanë fillu ato spasmet apo... edhe jom alivanosë. Edhe m'kanë marrë punëtorët e "Rilindjës", n'atë kohë domethonë di vetë që kërceja kështu {lëvizë trupin}. Edhe m'kanë çu në spital. Kom hupë pamën, domethonë për një kohë t'shkurtë prej efekteve të helmeve. Kanë pasë qenë në vizitë Zekeria Cana, n'atë kohë qe ishte m'dokët kryetar i Drejtave të Njeriut, ka qenë Veton Surroi. Kom edhe fotografi t'asaj kohe.

Mundoheshin më na vu ku mujshin, se s'kanë pasë salla, vend t'mjaftushëm se ishim shumë, shumë. Edhe kom qëndru aty disa... dy, tre ditë m'dokët edhe jom kthy në shpi.

Anita Susuri: Helmimi ka ndodhë si lloj...

Narimane Kamberi: Po... helmimet, domethonë jonë bo studime, ka pasë edhe dokumentar për to, ka qenë n'atë kohë edhe Bernard Kouchner² i cili osht' marrë me këtë çështjen e helmimeve. Tash a ka qenë nga ajri, osht' mundu se shumë, shumë pikëpytje kanë mbetë rreth atij helmimit. Sepse vërtetë që versioni i sërbeve ka qenë që ishte një histeri kolektive, tash krejt fëmitë, krejt... se kryesisht

² Bernard Kouchner KBE është politikan dhe mjek francez. Ai ishte Përfaqësues i OKB-së në Kosovë nga viti 1999 deri në vitin 2001.

nxeëset edhe t'rinjtë ishim prekë, që ishte një histeri kolektive. Po ajo definitivisht u dëshmu që ishte një helmim.

Tash, i kom pasë ma herët pak ma t'qarta t'dhanat se vërtetë osht' punu, se ka qenë edhe doktoresha Luci, e cila osht' marrë atëherë, ka qenë n'spital n'atë kohë. Edhe, tash a ka qenë një helmim me një shkallë t'madhe, a ka qenë vetëm me i frigu e jo me i mytë, këtë nuk e di, nuk di. Po e di që edhe vet, e kom edhe fotografi, që disa statute i kom pasë, e kthyerë, e helmuara, refugjate. Po sidomos dëshmitare edhe vëzhguese, sikur shumë njerëz, domethonë jo diçka të veçantë nga ana ime.

Po, ajo e mira që m'ka ndihmu shkrimi. Fatkeqësisht, jo ende në mënyrë letrare, nuk po muj, s'ka ardhë koha, po përmes reportazheve edhe t'flas për... edhe sidomos ato tri reportazhet që i kom bo mas, për njëzetë vjetorin. Madje, një mik i imi, që e pata marrë si personazh për çlirimin e Prishtinës tha, "Faleminderit se i kisha harru shumë gjana". Po e vrejë që edhe unë tash shumë gjana, tash me qëllim, pa qëllim, normal edhe mosha edhe ndoshta shumë gjëra kemi, kemi n'kujtesë. Ajo po m'ndihmon pak me i... poezi i kom shkru dy, njo për djaln para luftë, njo ktij që ka lindë mas luftë.

Domethonë, e kom gjetë ni mënyrë që domethonë nuk osht' ende ajo, po këtë po du me thanë që shumë pak kemi punu rreth edhe shumë, edhe osht' normale. Unë ju thashë përcjellë vazhdimisht edhe botën frankofone edhe përcjellë shkrimtarë edhe t'cilët ende apo kurrë s'kanë arritë me folë për çka kanë përjetu gjatë luftës, gjatë, gjatë nazizmit dhe këto. Po ne kemi punu shumë pak edhe s... me vetvetën, me të tjerët. Ngjarjet, situata jo-stabile, rindërtimi i shpirtit, rindërtimi i shtetit, nuk na ka lanë shumë kohë me u marrë me vetën, nuk kemi pasë shumë ndihmë n'atë aspekt edhe sot po shihen pasojat sigurisht.

Edhe kjo osht' normale, nuk osht' diçka e veçantë që i përket Kosovës, një vend post-konfliktuoz gjithmonë ka pasoja. Për shembull, çështja e dhunimeve, na e kemi ditë shumë herët, ne që punonim në terren, që kanë ndodhur edhe pse shumë pak kanë folë. Unë e mbaj n'mend në kamp erdh një gazetar francez, "A keni taku gra të dhunume?" Se ata e dinim prej Bosnjës. Edhe ne domethonë me këtë çështje jemi marrë shumë vonë, sepse s'kemi dashtë, sepse ato s'kanë dashtë, jonë faktorë të ndryshëm.

Po gjithsesi edhe këtë që po e bëni, që nuk duhet të harrohët edhe... sepse tash edhe më shumë se përpara, sepse tash jemi në një... unë shoh edhe më fëmijë edhe me studentë e mij, jemi në një kohë ku jemi të, të bombardum, kemi mbidozë informate, lajme të shpejta, të shumta edhe s'kemi kohë, edhe nuk duam me u marrë me këto gjërat e kalume. Unë e di që gjatë mbylljës kemi qëndru këtu, në këtë shpi me fëmijë edhe normal qe i rikthejshim do biseda edhe nuk donim me i ndëgjju ose thojshin, "Oh, nuk e kemi ditë". Kur them që fëmijët e mij nuk i dijnë, atëherë çka pritët prej tjerëve.

Po tash osht' edhe ma vështirë me punu me këtë memorien kolektive se s'kemi kohë, ky hardisku jonë {çon dorën lartë te koka} osht' tejet i ngrakum me lajme të mira, të kota, me informata të shumta. Edhe

fakti që po e rikthejmë këto gjërat... unë po thom, shkrimi, sepse unë ju thashë edhe në fillim kom shkru shumë e re, edhe vazhdoj me shkru. Tash domethonë e kom përfundu librin me tregime për pandeminë edhe... po p'e shoh që herë pas here po m'kthehet edhe lufta aty. Edhe shkrimi osht' ajo që m'ka ndihmu. E tash po shpresoj se s'po besoj që njerëzit gjejnë secili mënyrën për me i tejkalu këto, me u harru, nuk harrohen, por me i zbutë s'paku.

Anita Susuri: Zonja Neriman, nëse doni edhe diçka me shtu, ose që na nuk kemi pytë e që ish dashtë, ndoshta që nuk kemi prekë ndonjë temë nëse doni me shtu për fund?

Narimane Kamberi: Paj, sigurisht, diçka gjithmonë mbetet e pathanë, ne jse unë s'pari... nuk po kërkoj falje se emocionet jonë evidente në raste të tilla edhe unë gjithmonë thom që... se ndonjëhere i vë edhe njerëzit në siklet e shoh edhe me t'hujtë kur e spjegoj, po osht'... domethonë sa ma shpejtë që t'krijohet një ambient stabil, një vend ku mund t'jetosh një jetë të dinjitetshme edhe pse absolutisht s'ka ideal, edhe aq ma lehtë i tejkalojmë këto, këto vuajtjet, edhe aq ma lehtë merremi më mënyrë shumë shkencore, me historinë tonë.

[Këtu ndërprehet intervista]

Po, domethonë ajo, nëse për mbas lufte, ajo që sigurisht që osht' dashtë, edhe pse duhet kohë e osht' e vështirë, osht' dashtë që sa ma shpejtë ta krijojmë një vend të dinjitetshëm, një ambient, një vend stabil me jetu. Sepse një e kaluar e dhimbshme edhe një e tashme e mundimshme nuk, nuk të ndihmon ta shërosh një popull. Edhe një popull i cili nuk është shëru shpirtërisht nga gjithë këtë të kaluar që e kemi me gjenerata, jo vetëm ne që e përjetum, atëhere nuk sjellë një vend të... edhe pse prapë po them, unë nga leximet, nga kultura që e kom, shumë, shumë debate, Franca ende merret me luftën e Algjerisë, gjermanët e tash merren me diçka... gjithmonë vjen diçka më vonë me t'cilën kemi refuzu, me t'cilën kemi refuzu t'ballafaqohemi ose s'kemi ditë. Edhe kjo ka qenë domethonë e dhimbshme.

Une sigurisht s'kom pasë kurrë iluzione që ka me qenë Kosova parajsë, siç jonë do njerëz që i njoh, "U kthym ne, boll mirë ishim në Gjermani, në Kanadë, e t'i kthehemi Kosovës". Që gjithmonë e kom n'mend një, një fqinje këtu, fshatare që thoshte, tha, "M'kthej burri, e tash çka po boj? Po e ruj lumin". Se tha, "Boll mirë isha". Atë ide. E domethonë ajo osht' shumë, shumë... me pasë sot me ikë prapë rinija, a na kemi ikë boll, me dalë... domethonë tash do të doja me dalë me protestu për një gja shumë koti, jo për gjëra të mdhaja.

Edhe sigurisht që gjenerata jonë tash osht' mirë që t'ja u spjegojmë, t'ja tregojmë edhe t'rijve këto, normal domethonë na i kemi pasë momentë ngazëllyse tash se s'po du me bo krejt zi. Po e lehtë sigurisht s'ka qenë. Po shumë procese te na kanë ardhur shumë vonë. Tash unë nuk po vë gishtin asnjërin ta akuzoj kon, se nuk e kom këtë qëllim, edhe as nuk osht' puna këtu. Po si vend i vogël shumë

vonë do procese kanë ardhë edhe po shihët sot, edhe te gjendja shpirtërore, kur i sheh raportet, edhe ekonomike, edhe psikologjike të Kosovës, këto jonë domethonë pasoja të gjithë asaj që kemi bo.

Edhe mu po m'vjen shumë mirë që n'këtë rast jom femën, edhe gjithmonë kom thonë, "Shumë mirë që jom..." Domethonë, kurrë nuk e kom pasë problem me këtë çështje, po që s'paku ta çojmë zërin e... zërin tonë siç ju thashë ma herët, me rolet që na i ka atribu shoqëria edhe historia, rolet që na i ka marrë ndonjëhere shoqëria edhe përnjëherë, pa dashjën tonë, në mënyrë të dhunshme, në mënyrë... na u kanë dhanë, të prirjes, të udhëheqjes së familjës, të, të shtyllës, domethonë ja kemi dalë, jo pa pasoja, po ja kemi dalë shumë mirë. Shumë mirë se ku kemi qenë, e ku jemi tash, e kjo osht' pozitive. Po ka sigurisht tash, një thënië shumë banale, po ka shumë hala për t'bërë.

Anita Susuri: Faleminderit shumë për rrëfimin e ju, zonja Nerimane.

Narimane Kamberi: Faleminderit juve.